

PASTIRIMI I BESIMIT



Imam es-San'ani

PASTRIMI I BESIMIT

NGA

NDYRËSITË E ATEIZMIT

Autor

Imam Muhamed Ismail es-San'ani

Përktheu

Agron Milazim Krasniqi

Titulli: **Pastrimi i besimit nga ndyrësitë e ateizmit**

Titulli në origjinal: (تطهير الاعتقاد عن أدران الإلحاد)

Autor: **Imam Muhamed Ismail es-San'ani**

Përktheu: **Agron Krasniqi**

Redaktor fetar: **Hadith Miftari**

Redaktor gjuhësor: **Jeton Koçinaj**

Ballina: **Rexhep Dajçi**

Të drejtën për botim: **Përkthyesi**

E-mail: **goni_81@hotmail.com**



NJOHJE ME AUTORIN

Emri i tij i plotë është Muhamed ibn Ismail ibn Salah ibn Muhamed ibn Ali El-Kuhalani, pastaj Es-Sanani. Familja e tij njihet me emrin *El-Emir*, emër me të cilin u njoh edhe autori, si El-Emir Es-Sanani.

Gjenealogjia e tij rrjedh nga nipi i të Dërguarit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, Hasan ibn Ali ibn Ebi Talibit, *Allahu qoftë i kënaqur me ta*.

Ka lindur në vitin 1099 h në qytetin Kuhalan, Jemen, prej nga edhe e mori emrin El-Kuhalani.

Në moshën tetëvjeçare udhëtoi me babanë e tij për në qytetin Sana (kryeqyteti i Jemenit). Aty e mësoi Kuranin përmendsh, ende pa i mbushur 10 vjet. Më pas, nxënien e dijes e filloi te dijetarët e këtij vendi, ku u dallua me aftësitë e veta, saqë i tejkaloi kolegët e tij në dije. U shqua në kapjen për argumenti, për lënien e pasimit të verbër, për punën sipas argumenteve të Kuranit dhe të Sunetit të vërtetë.

Gjithashtu, udhëtoi disa herë në krahinën e Hixhazit (Mekë e Medinë), ku mori dije në lëmenj të ndryshëm, te dijetarë të njohur të këtyre vendeve.

Mësoi te këta dijetarë të mëdhenj të kohës:

- **Shejhul-alameh Zejd ibn Muhamed ibn El-Hasan ibn El-Kasim** (1123 h), dijetar i madh, në kohën e tij, i njohur si kryedijetar (dijetar i dijetarëve). Prejt tij mësoi lëmenj të ndryshëm të Sheriatit.
- **Shejhul-alameh Salah ibn El-Husejn Es-Sanani** (1142 h), dijetar i shquar, prej të cilit e mësoi librin *Sherhul-ez'har*.
- **Shejhul-alameh Abdullah ibn Ali ibn Ahmed** (1147 h), dijetar i shquar në lëmin e tefsirit.
- **El-Kadi-alameh Ali ibn Muhamed Es-Sanani** (1139 h).
- **Shejh Abdurrahman ibn Ebi El-Gajth**, ligjërues (*hatib*) në Xhaminë e të Dërguarit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, në Medinë.

Ka me dhjetëra dijetarë të tjerë te të cilët mësoi imam Es-Sanani, por po mjaftohemi me të lartpërmendurit.

Pozita e dijes së tij:

Ai ishte dijetar i shquar në shkencat mendore dhe fetare, sidomos në shkencën e hadithit, në të cilën e kishte arritur kulminacionin. Rrjedhimisht, u njoh si imam i padiskutueshëm i muxhtehidëve të Jemenit.

Personaliteti i imam Es-Sananit u dallua me disa **veçori** dhe **qëndrime**, si:

Kapja për argument dhe lënia e pasimit të verbër; largimi nga ekstremizmi në pasimin e njerëzve qorrazi (pa argument); qartësimi dhe mospërfillja e mendimeve të paargumentuara fikhore etj.

Gjithashtu, u dallua me thirrjen e tij në njësimin e Allahut, të adhurohet vetëm Ai, me largimin nga shirku ndaj Allahut me të gjitha llojet e tij (shirkut), me thirrjen në ndalimin e ndërmjetësimit (*tevesulit*) që shpie në shirk, me thirrjen e njerëzve në pasimin e Sunetit të të

Dërguarit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, dhe në largimin nga risitë (bidatet).

U angazhua në mësimin e njerëzve nëpër xhamitë e Sanasë në Jemen, jepte mësimë në lëmenj të ndryshëm, si: fikh, usul fikh, tefsir, bejan, hadith etj.

Qëndrimet dhe thirrja e tij patën ndikim të madh te njerëzit, saqë ata filluan t'i përgjigjen thirrjes (davetit) të tij në njësimin e Allahut dhe në largimin nga shirku, zunë ta duan Sunetin e të Dërguarit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, të kujdesen për të, ta praktikojnë dhe të punojnë sipas tij.

Duke parë këtë, disa zemërligë, pasues të bidatit, e xhelozuan imamin, kështu që filluan të intrigojnë dhe të gënjejnë kundrejt tij, që t'ia zbrapsnin njerëzit.

Si pasojë e kësaj, imami i nderuar u sprovua si shumë dijetarë para tij, siç sprovohet secili që i përmbahet të vërtetës dhe thërret në të. Rrjedhimisht, shumë herë u dëbua nga vendi i tij dhe u burgos. Madje, iu kanos edhe jeta e tij, mirëpo Allahu i Lartësuar e mbrojti këtë nga kurthet e njerëzve të ligë, e për këtë falënderimi i takon Allahut.

Ç'kanë thënë dijetarët për të:

Imam Esh-Sheukani në *El-Bedr et-tali* për të thotë: "Ai është imam, muxhtehid i përgjithshëm, autor kryeveprash." Gjithashtu, thotë: "U dallua në të gjitha shkencat, i tejkaloi kohanikët e vet, ishte prijës i ditorisë në Sana, u shqua me *ixhtihadin* e tij, me punën sipas argumentit, me largimin nga pasimi i verbër, me mospërfillje të mendimeve që nuk kanë për bazë argumentin."

El-alameh Muhamed ibn Ishak¹ El-Mehdiu e shkroi poezinë e tij të njohur ku e lavdëron imam Es-Sananin.

Shejh Sulejman ibn Sahman (dijetar i shquar i Nexhdit) e shkroi librin e tij të njohur ku mbron dhe lavdëron të dy imamët e shquar: imam Muhamed ibn Abdul-Vehabin dhe imam Muhamed ibn Ismail Es-Sananin. *Allahu i mëshiroftë të gjithë!*

¹ Lexo: Is'hak.

Veprat e tij:

Ai ka shkruar më se 300 vepra në fusha të ndryshme të Islamit, shumë prej të cilave janë botuar dhe gjenden nëpër librari islame. Ndër librat më të njohur në lëmin e fikhut është kryevepra *Subulus-Selam, sherh Bulugilmeram*, kurse në lëmin e akides, libri që keni në dorë *Tet'hirul-itikad an edranil-ilhad*.

Imam Es-Sanani ka vdekur në moshën 83 vjeçare, në vitin 1182 h.

E lusim Allahun e Lartësuar ta mëshirojë me mëshirën e Tij të gjerë, t'i mëshirojë të gjithë dijetarët e Islamit dhe të gjithë muslimanët! Ai është Mëshirues dhe Falës.

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve.

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

Ndihmë prej Tij kërkojmë. O Zot, lehtëso dhe ndihmo! O Bujar!

Imami i shquar, shejh Muhamed ibn Ismail Es-Sanani, Allahu e mëshiroftë, shkruan:

Hyrja

Falënderimi i takon Allahut, i Cili **nuk e pranon** nga robërit e Tij besimin në njësimin e Allahut (*teuhid er-rububije*)¹ **derisa** ta njësojnë Atë në njësimin e adhurimit (*teuhid el-uluhije*)², duke e veçuar Atë plotësisht nga zotat

¹ *Teuhidi rububije* apo njësimi i Allahut në krijim nënkupton: të besosh se Allahu është Zot dhe Krijues i Gjithësisë, Pronar i saj, Krijues i gjithçkaje, Furnizues, që u jep jetë dhe vdekje krijesave të Tij. Ai është që sjell dobi dhe dëm, u përgjigjet lutjeve, çdo gjë është në dorën dhe në caktimin e Tij, si dhe gjëra të tjera që ndërlihen me këtë lloj teuhidi.

² *Teuhidi uluhije* apo njësimi i Allahut në adhurim nënkupton: të besosh se vetëm Allahut i takon adhurimi. Ndërkaq, adhurimi është shumë llojesh, si: namazi, lutja, zekati, agjërimi, haxhi, bindja, nënshtrimi, përkulja, frika, shpresa, kërkimi i ndihmës, pendimi etj.

e tjerë. Pra, të mos marrin për zot dikë tjetër krahas Allahut, të mos lusin ndokënd krahas Tij, t'i mbështeten vetëm Atij, për çfarëdo gjendje në të cilën gjenden të kthehen vetëm tek Ai, të mos e lutin Atë me emra të pahijshëm dhe të mos marrin ndërmjetës për tek Allahu. Allahu i Lartësuar thotë:

﴿مَنْ ذَا الَّذِي يَشْفَعُ عِنْدَهُ إِلَّا بِإِذْنِهِ﴾ [البقرة: ٢٥٥]

“Kush mund të ndërhyjë tek Ai për ndokënd pa lejen e Tij?” (Bekare, 255)

Po ashtu thotë:

﴿فَأَرُونِي مَاذَا خَلَقَ الَّذِينَ مِنْ دُونِهِ﴾ [لقمان: ١١]

“Më tregoni çfarë kanë krijuar të tjerët pos Tij?” (Lukman, 11)

Dëshmoj se nuk ka zot tjetër që e meriton adhurimin pos Allahut të Vetëm, të Pashoq. Nuk ka zot e as të adhuruar pos Tij dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i dërguar i Tij, i Cili e ka urdhëruar atë të thotë:

﴿قُلْ لَا أَمْلِكُ لِنَفْسِي نَفْعًا وَلَا ضَرًّا إِلَّا مَا شَاءَ اللَّهُ﴾ [الأعراف: ١٨٨]

“Thuaj: “Unë nuk mund t’i sjell vetes as dobi, as dëm, përveçse aq sa dëshiron Allahu.” (Araf, 188)

Mjafton Allahu si dëshmitar. Paqja e Allahut qoftë mbi të Dërguarin e Tij, mbi familjen e tij dhe mbi ata që e pasuan me besim të pastër dhe me zemër të shëndoshë duke mos e ndotur besimin e tyre me asgjë.

Kështu, ky është *Pastrimi i besimit nga ndyrësitë e idhujtarisë dhe mohimit*. M’u duk e obligueshme të shkruaj dhe të sqaroj, pasi që pashë dhe u binda se sot shumë njerëz i bëjnë shirk¹ Allahut, në qytete, në fshatra e në të gjitha vendet, si: Jemen, Sham, Nexhd, Tuhameh dhe në të gjitha rajonet islame.

¹ *Shirku* nënkupton: përkushtimi i adhurimeve dikujt tjetër, krahas Allahut, apo t’i shoqërosh Allahut ortak(ë) në adhurimet që janë të veçanta vetëm për të.

Ky lloj shirku është: besimi në varreza¹ apo në ndonjë njeri të gjallë, që pretendon se ndonjëri prej tyre e di të fshehtën (*gajbin*), kurse në të vërtetë ai është vetëm një i prishur e mëkatar.² I tilli nuk është i pranishëm nëpër xhamitë e muslimanëve, Allahut nuk i bën as ruku e as sexhde, nuk e njeh aspak Kuranin e as Sunetin, e as që do t'ia dijë për ringjalljen e për llogarinë.

Duke parë këto gjëra, e pashë si të obligueshme t'ua tërheq vërejtjen njerëzve në atë që na ka obliguar Allahu, e të mos jem prej atyre që e fshehin atë që Allahu na e ka bërë obligim t'ua paraqesim të tjerëve.

¹ Siç është e njohur edhe në disa vende tonat tek besojnë kinse i vdekuri u sjellka dobi dhe dëm, andaj i sheh se si drejtohen te varret e disa njerëzve të caktuar (siç janë tyrbet, teqetë etj.), në ditë të caktuara (siç është e ashtuquajtura *Dita e shën Gjergjit*). Të gjorët besojnë se ata mund t'u përgjigjen nevojave dhe dëshirave që kanë, si: kërkimi i fatit, shërimi i sëmundjeve, kërkimi i fëmijës etj? Atyre u drejtohen me lutje e me adhurime, në vend të Allahut. I Lartësuar qoftë Allahu nga ajo që bëjnë të padrejtët!

² Siç janë falltarët, magjistarët dhe ata që shkruajnë. Po që se ua shikon gjendjen, do t'i shohësh se me të vërtetë janë mu ashtu siç i përshkruan autori.

Kapitulli: *Disa baza të fesë*

Dije, o musliman, se ekzistojnë disa baza apo rregulla, e që janë baza të fesë dhe prej gjërave më të rëndësishme që obligohet t'i dijë monoteisti (*muvahidi*), muslimani që e ka njësuar dhe e ka besuar Allahun:

Baza e parë: *Ç'ka në Kuran është e vërtetë (hak).*

Prej gjërave fetare që duhet njohur domosdoshmërisht është se, çdo gjë që është në Kuran është e vërtetë (hak) dhe nuk ka kotësi në të:

(çdo gjë) është e vërtetë e jo gënjeshtër, udhëzim e jo humbje, dituri e jo injorancë, bindje e jo dyshim.

Kjo është bazë pa të cilën nuk vlen Islami e as besimi i askujt që nuk e pranon atë.

Kjo është çështje në të cilën nuk ka diskutim.

Baza e dytë: Të dërguarit e Allahut janë dërguar për ta njësuar Allahun në adhurim.

Të dërguarit e Allahut, që nga i pari e deri tek i fundit, janë dërguar t'i ftojnë njerëzit për ta adhuruar vetëm Allahun. Gjëja e parë që ka dëgjuar secili popull nga çdo i dërguar i tyre është:

﴿يَقَوْمِ اعْبُدُوا اللَّهَ مَا لَكُمْ مِنْ إِلَهٍ غَيْرُهُ﴾ [الأعراف: ٥٩]

“O populli im! Adhuroni Allahun, ju nuk keni zot tjetër përveç Tij.” (Araf, 59)

﴿أَنْ لَا تَعْبُدُوا إِلَّا اللَّهَ﴾ [هود: ٢٦]

“... që të adhuroni vetëm Allahun.” (Hud, 26)

﴿أَنْ اعْبُدُوا اللَّهَ وَاتَّقُوهُ وَأَطِيعُوا﴾ [نوح: ٣]

“... që të adhuroni Allahun, t'i frikësoheni Atij dhe të më bindeni mua.” (Nuh, 3)

Kjo është domethënia e fjalës *La ilahe il-Allah*. Të dërguarit e Allahut u dërguan te popujt e tyre për t'i

thirrur ata në këtë fjalë; ta thonë, ta besojnë dhe të binden në kuptimin e saj, e kurrsesi nuk u dërguan që ata (njerëzit) ta shqiptojnë vetëm me gjuhë.

E, kuptimi i saj është: **njësimi i Allahut në adhurim, mohimi i zotave që adhurohen përveç Tij dhe largimi prej tyre.**

Nuk ka fije dyshimi në përmbajtjen e këtij themeli dhe se nuk pranohet besimi i askujt derisa ta njohë dhe ta besojë këtë.

Baza e tretë: *Llojet e teuhidit*

Teuhidi ndahet në dy lloje:

Lloji i parë: **Teuhidi er-rububije, besimi dhe njësimi i Allahut në krijim, në furnizim etj.**

Kuptimi i tij është se: vetëm Allahu është Krijues i botës dhe ç'ka në të. Ai është Zoti dhe Furnizuesi i tyre.

Këtë nuk e mohojnë as idhujtarët dhe në të nuk ia shoqërojnë askë Allahut, madje ata e pranojnë këtë teuhid,¹ siç do ta sqarojmë në bazën e katërt.

Lloji i dytë: Teuhidi el-uluhije, njësimi në adhurim.

Kuptimi i tij është: njësimi i Allahut, të Vetmit, në të gjitha llojet e adhurimeve, lloje të cilat do t'i sqarojmë më poshtë.

Ky është teuhidi në të cilin i është bërë ortakëri Allahut. Fjala “ortakëri” apo “shoqërim” do të thotë se ata e kanë pranuar Allahun për Zot, mirëpo Atij i kanë shoqëruar zota të tjerë. Andaj, të dërguarit, *alejhim selam*, u dërguan për ta vërtetuar llojin e parë të teuhidit dhe për t'i thirrur politeistët (mushrikët) në llojin e dytë, siç iu drejtuan atyre me sa vijon:

¹ Ky lloj teuhidi (i vetëm) nuk i bën dobi njeriut dhe nuk e shpëton prej dënimit të përhershëm në Zjarr pa ia bashkangjitur llojin e dytë të teuhidit, respektivisht teuhidin e adhurimit. Pra, nuk është i vlefshëm identifikimi i ndonjë personi me Islam e as të quhet musliman po qe se nuk i harmonizon këto dy themele: Besimi se vetëm Allahu është Zot, Krijues, Furnizues dhe se besimi e nënshtrimi ndaj Tij me adhurim. Pa këto dyja askush nuk mund të shpëtojë në jetën e pasvdekjes.

﴿أَفِي اللَّهِ شَأْنٌ﴾ [إبراهيم: ١٠]

“Vallë, a mund të dyshohet në Allahun...?!” (Ibrahim, 10)

﴿هَلْ مِنْ خَلْقٍ غَيْرِ اللَّهِ﴾ [فاطر: ٣]

“A ka ndonjë krijues, veç Allahut...?” (Fatir, 3)

Gjithashtu, i ndaluan nga shirku në adhurim, siç thotë Allahu i Lartësuar:

﴿وَلَقَدْ بَعَثْنَا فِي كُلِّ أُمَّةٍ رَسُولًا أَنِ اعْبُدُوا اللَّهَ وَاجْتَنِبُوا الطَّاغُوتَ﴾ [النحل:

[٣٦

“Çdo populli Ne i çuam një të dërguar.” Që t'u thotë atyre: **“Adhuroni Allahun dhe shmangni idhujt”** (Nahl, 36)

Fjala e Allahut (në ajetin e sipërcituar) **“Çdo populli...”** tregon se popujve nuk i është çuar i dërguari për t'u mësuar se Allahu është Krijuesi i tyre apo se është Zot i qiejve dhe i Tokës, ngase ata e pranonin një gjë të tillë.

Mu për këtë, në të shumtën e rasteve, ajetet kuranore të kësaj tematike kanë ardhur në formën pyetëse, si:

﴿ هَلْ مِنْ خَلْقِ عِبْرِ اللَّهِ ﴾ [فاطر: ٣]

“A ka ndonjë krijues, veç Allahut...?” (Fatir, 3)

﴿ أَفَمَنْ يَخْلُقُ كَمَنْ لَا يَخْلُقُ أَفَلَا تَذَكَّرُونَ ﴾ [النحل: ١٧]

“Atëherë, a është njësoj si Ai që krijon, si ai që nuk krijon?!” (En-Nahl, 17)

﴿ أَفِي اللَّهِ شَكٌّ فَاطِرِ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ ﴾ [إبراهيم: ١٠]

“Vallë, a mund të dyshohet në Allahun, Krijuesin e qiejve dhe të Tokës?!” (Ibrahim, 10)

﴿ قُلْ أَعْبُدُوا اللَّهَ أَمَّا أَنَا فَأَتَّبِعُ آلِهَتِي وَإِنِّي مِنَ الْمُمِيقِينَ ﴾ [الأنعام: ١٤]

“Thuaj: “A të marr mbrojtës tjetër, përveç Allahut, Krijuesit të qiejve dhe Tokës?” (Enam, 14)

﴿ فَارْؤُفِ مَاذَا خَلَقَ الَّذِينَ مِنْ دُونِهِ ﴾ [لقمان: ١١]

“Më tregoni çfarë kanë krijuar të tjerët pos Tij?”

(Lukman, 11)

﴿ قُلْ أَرَأَيْتُمْ مَا تَدْعُونَ مِنْ دُونِ اللَّهِ أَرُونِي مَاذَا خَلَقُوا مِنَ الْأَرْضِ ﴾ [الأحقاف: ٤]

“Thuaju: "A i shihni ata që i adhuron në vend të Allahut? Më tregoni, çfarë pjese të Tokës kanë krijuar ata?!” (Ahkaf, 4)

Meqë këto ajete kanë ardhur në formën pyetëse, nënkupton se ata e pranonin këtë.

Pra, me këtë kuptohet se idhujtarët (mushrikët), idhujt dhe putat **nuk** i kanë marrë për t'i adhuruar e as nuk e kanë marrë për zot Isanë dhe nënën e tij, as engjëjt (melekët) për zota në vend të Allahut, ngase politeistët besonin se këta janë pjesëmarrës në krijimin e qiejve e të Tokës dhe në vetë krijimin e tyre.

Porse, i kanë marrë për zota sepse, gjithnjë sipas tyre, ata i afrojnë tek Allahu.

Gjithashtu, ata e kanë pranuar Allahun për Zot në vetë fjalët e tyre mohuese dhe se ata që i kanë adhuruar pos Allahut i kanë konsideruar ndërmjetës për tek Ai.

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿وَيَعْبُدُونَ مِن دُونِ اللَّهِ مَا لَا يَضُرُّهُمْ وَلَا يَنْفَعُهُمْ وَيَقُولُونَ هَؤُلَاءِ شَفَعَتُنَا

عِنْدَ اللَّهِ قُلْ أَتَنْتَبِهُونَ اللَّهَ بِمَا لَا يَعْلَمُ فِي السَّمَوَاتِ وَلَا فِي الْأَرْضِ سُبْحَانَهُ، وَتَعْلَى

عَمَّا يُشْرِكُونَ ﴿١٨﴾ [يونس: ١٨]

“Ata adhurojnë në vend të Allahut atë që nuk u bën dëm, as nuk u sjell dobi dhe thonë: “Këta janë ndërmjetësit tanë tek Allahu!” Thuaj: “A po i tregoni Allahut për diçka që Ai nuk e di në qiej dhe në Tokë?” Qoftë i lavdëruar Ai dhe i lartësuar mbi gjithçka që ia shoqërojnë (në adhurim)!” (Junus, 18)

Pra, Allahu i Lartësuar e konsideroi shirk (shoqërim në adhurim) konsiderimin e tyre ndërmjetës tek Ai, ngase askush nuk mund të ndërmjetësojë tek Allahu pa lejen e Tij. Andaj, me ç’të drejtë i marrin ata si ndërmjetës pa u

dhënë leje Allahu për këtë, pa qenë ata meritorë për këtë dhe as që kanë gjë në dorë para Allahut?!

Baza e katërt: Idhujtarët (mushrikët) besonin se Allahu i Lartësuar është Krijues i tyre.

Mushrikët, te të cilët Allahu i çoi të dërguarit, besonin se Allahu i Lartësuar është Krijues i tyre. Allahu në Kuran thotë:

﴿وَلَيْن سَأَلْتَهُمْ مَنْ خَلَقَهُمْ لَيَقُولُنَّ اللَّهُ فَأَنَّى يُؤْفَكُونَ﴾ [الزخرف: ٨٧]

“Nëse i pyet ata se kush i ka krijuar, me siguri ata do të thonë: “Allahu!” (Zuhruf, 87)

Pranonin se është Ai që i ka krijuar qiejt dhe Tokën, siç thotë në Kuran:

﴿وَلَيْن سَأَلْتَهُمْ مَنْ خَلَقَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ لَيَقُولُنَّ خَلَقَهُنَّ الْعَزِيزُ الْعَلِيمُ﴾

[الزخرف: ٩]

“Nëse ti i pyet ata: “Kush i ka krijuar qiejt dhe Tokën?” Ata, me siguri do të thonë: “Ato i ka krijuar i Plotfuqishmi dhe i Gjithëdijshti.” (Zuhruf, 9)

Gjithashtu, pranonin se Ai është Furnizues, i cili nxjerr të gjallin prej të vdekurit e prej të gjallit e nxjerr të vdekurin. Ai është që rregullon çdo gjë në Tokë dhe në

qiell dhe Ai është i Cili ka nën kontroll shikimet, dëgjimet dhe të folurit:

﴿ قُلْ مَنْ يَرْزُقُكُمْ مِنَ السَّمَاءِ وَالْأَرْضِ أَمَّنْ يَمْلِكُ السَّمْعَ وَالْأَبْصَرَ وَمَنْ يُخْرِجُ الْحَيَّ مِنَ الْمَيِّتِ وَيُخْرِجُ الْمَيِّتَ مِنَ الْحَيِّ وَمَنْ يُدِيرُ الْأَمْرَ فَسَيَقُولُونَ اللَّهُ فَقُلْ أَفَلَا تَنْقُرُونَ ﴾ [٣١] [يونس:

[٣١]

“Thuaj: “Kush ju furnizon nga qielli dhe Toka? Kush e ka në dorë të dëgjuarit dhe të parit? Kush e nxjerr të gjallin nga i vdekuri dhe të vdekurin nga i gjalli? Kush i drejton gjërat?” Ata do të thonë: “Allahu”. Ti thuaj: “Atëherë, përse nuk e keni frikë Atë?” (Junus, 31)

﴿ قُلْ لِمَنِ الْأَرْضُ وَمَنْ فِيهَا إِنْ كُنْتُمْ تَعْلَمُونَ ﴾ [٨٤] سَيَقُولُونَ لِلَّهِ قُلْ أَفَلَا تَذَكَّرُونَ ﴿٨٥﴾ قُلْ مَنْ رَبُّ السَّمَوَاتِ السَّبْعِ وَرَبُّ الْعَرْشِ الْعَظِيمِ ﴿٨٦﴾ سَيَقُولُونَ لِلَّهِ قُلْ أَفَلَا تَنْقُرُونَ ﴿٨٧﴾ قُلْ مَنْ يُبْدِيهِمْ مَلَكُوتَ كُلِّ شَيْءٍ وَهُوَ يُخْفِيهِمْ وَلَا يَجَارُ عَلَيْهِ إِنْ كُنْتُمْ تَعْلَمُونَ ﴿٨٨﴾ سَيَقُولُونَ لِلَّهِ قُلْ فَأَنَّى تُسْحَرُونَ ﴿٨٩﴾ [المؤمنون: ٨٤ - ٨٩]

“Thuaj: “E kujt është Toka dhe gjithçka që gjendet në të, nëse e dini?”Ata do të thonë: “Të Allahut!” E ti thuaju: “Vallë, a nuk po ia vini veshin?” Thuaj: “Kush është Zoti i shtatë qiejve dhe Zot i Fronit

Madhështor?” Ata do të thonë: “Allahu!” E ti thuaju: “Vallë, a nuk keni frikë ju?” Thuaj: “Kush është Ai që ka në dorë pushtetin mbi çdo gjë, i Cili mbron, por prej Tij nuk mund të mbrohet askush; nëse e dini?” Ata do të thonë: “Allahu!” E ti thuaju: “Atëherë, përse magjepseni?” (Muminun, 84-89)

Madje, edhe për Faraonin, i cili, me kryelartësinë që kishte dhe me pretendimin e tij të shëmtuar,¹ Allahu i Lartësuar tregon nëpërmjet Musait, *alejhi selam*, se:

﴿ قَالَ لَقَدْ عَلِمْتَمَا أَنْزَلَ هَؤُلَاءِ إِلَّا رَبُّ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ بِصَآئِرٍ وَإِنِّي لَأَظُنُّكَ

يَنْفِرَعَوْتُ مُشْرِكًا ﴿١٠٢﴾ [الإسراء: ١٠٢]

¹ Faraoni ka qenë ndër zullumqarët më të njohur në historinë e njerëzimit, saqë padrejtësia e tij kishte arritur deri në atë shkallë sa ta quante veten zot. Allahu, në lidhje me këtë, tregon në Kuran se Faraoni thoshte: “O ju njerëz, nuk di të ketë për ju zot tjetër pos meje.” (Kasas, 38) Dhe thoshte: “Unë jam zoti juaj më i larti.” (Naziat, 24)

“Ai (Musai) tha: “Po ti e di (o Faraon) se ato (mrekullitë) nuk i zbriti askush tjetër pos Zotit të qiejve dhe të Tokës, i zbriti të dukshme.” (Isra, 102)

Ndërkaq, Iblisi ka thënë:

﴿إِنِّي أَخَافُ اللَّهَ رَبَّ الْعَالَمِينَ﴾ [الحشر: ١٦]

“Unë i frikësohem Allahut, Zotit të botëve.” (Hashr, 16) Gjithashtu ka thënë:

﴿قَالَ رَبِّ يَا آغْوِيَنِي﴾ [الحجر: ٣٩]

“Zoti im, meqë më humbe...” (Hixhr, 39)

Dhe:

﴿قَالَ رَبِّ فَأَنْظِرْنِي﴾ [الحجر: ٣٦]

“Zoti im, më jep pra afat...” (Hixhr, 36)

Dhe çdo politeist e pranon dhe beson se Allahu është Krijuesi i tij dhe Krijuesi i qiejve dhe i Tokës, Zot i tyre

dhe ç'ka në to. Ai është Furnizuesi i tyre, andaj të dërguarit iu kundërpërgjigjën atyre me fjalët:

﴿ أَفَمَنْ يَخْلُقُ كَمَنْ لَا يَخْلُقُ ﴾ [النحل: ١٧]

“Atëherë, a është njësoj si Ai që krijon, si ai që nuk krijon?!” (Nahl, 17)

Dhe:

﴿ إِنَّ الَّذِينَ تَدْعُونَ مِنْ دُونِ اللَّهِ لَنْ يَخْلُقُوا ذُبَابًا وَلَوْ اجْتَمَعُوا لَهُ ﴾ [الحج: ٧٣]

“Idhujt që ju i adhuroni në vend të Allahut, nuk mund të krijojnë as edhe një mizë, edhe nëse bashkohen të gjithë për këtë.” (Haxh, 73)

Pra, politeistët e besonin këtë lloj teuhidi, e nuk e mohonin.

Baza e pestë: *Thelbi i adhurimit është njësimi i Allahut.*

Adhurimi (ibadeti) është shkalla më e lartë e nënshtrimit dhe përruljes. Si i tillë, përdoret vetëm për nënshtrim ndaj Allahut të Lartësuar sepse vetëm Ai është i Denjë për këtë.

Pastaj, adhurimi kryesor (kulmi) dhe thelbi tij është njësimi i Allahut të Lartësuar në adhurim apo teuhidi, që gjendet në fjalët që kanë thirrur të gjithë të dërguarit, ajo është fjala ***La ilahe il-Allah***. Ajo që synohet përmes kësaj fjale është kuptimi i saj (e jo vetëm shqiptimi).

Ndërkaq, **kuptimi** i saj është:

Njësimi i Allahut në adhurim, mohimi dhe largimi nga çdo gjë (e çdokush) që adhurohet në vend të Tij.¹

¹ Fjala *La ilahe il-Allah*, sipas kuptimit të saj, përmban dy shtylla: **1. Mohimin** (*La ilahe*), që ka për qëllim mohimin e çdokujt (a çdo gjëje) që adhurohet përveç (a krahas) Allahut; **2. Pohimin** (*il-Allah*), besimi se vetëm Allahu është Zot që e meriton adhurimin. Argument për këtë është fjala e Allahut në Kuran: **“Ai që mohon tagutin** (çdo gjë që

Kuptimin e kësaj fjale e dinin jobesimtarët (qafirët) e kohës së të Dërguarit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, sepse ata ishin njohës të gjuhës arabe, andaj, (kur i Dërguari i ftoi në këtë fjalë), thanë:

﴿ أَجْعَلُ الْأَلِهَةَ إِلَهًا وَجِدًا إِنَّ هَذَا لَشَيْءٌ عُجَابٌ ﴾ [ص: ٥]

“A mos kërkon ai, që të gjithë zotat t’i bëjë Një Zot të Vetëm? Vërtet që kjo është një gjë e çuditshme!”¹
(Sad, 5)

adhurohet në vend të Allahut) **dhe beson në Allahun, ka siguruar lidhjen më të fortë.**” (Bekare, 256) Ndërkaq, **lidhja më e fortë** është fjala *La ilahe il-Allah*.

¹ Imam Taberiu e shënon shkakun e zbritjes së këtij ajeti kuranor, përcjellë nga Said ibn Xhubejri, nga Ibn Abasi, *radijallahu anhuma*, që thotë: “Kur u sëmur Ebu Talibi (axha i të Dërguarit, *sal-lallahu alejhi ue selem*), erdhi një grup kurejsh i Mekës. Me ta ishte edhe Ebu Xhehli. Kështu, filluan t’i ankoreshin ndaj Muhamedit, *alejhi salatu ue selam*, duke thënë: “I biri i vëllait tënd po i fyen zotat tanë. Ai po bën kështu e ashtu dhe po thotë këtë e atë kundër tyre. Sikur ta thirrje këtu dhe ta ndaloje prej kësaj.” Ebu Talibi dërgoi dikë dhe Muhamedi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, erdhi dhe u ul pranë derës. Ebu Talibi i tha: “O biri i vëllait tim! Ç’është me këta njerëz që po ankohen se ti po ua fyen zotat dhe po thua ndaj tyre kështu e ashtu...” Filluan t’ia numëronin ato që

thoshte! I Dërguari i Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selem*, foli dhe tha: "O axha im! Këta i thërras te një fjalë, që, nëse e thonë, të gjithë arabët do t'u nënshtrohen dhe joarabët do t'ua paguajnë xhizjen (Iloj tatimi)." Me të thënë këtë, kurejshët u shtangën. Disa prej tyre thanë: "Një fjalë?! Për babanë tënd (Iloj betimi), edhe dhjetë si kjo (do t'i thoshim). Cila na qenka ajo fjalë?" Ebu Talibi i tha: "Cila është ajo fjalë, o bir?" I Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, u tha: "*La ilahe il-Allah*." Kurejshët u ngritën të zemëruar dhe thanë: "**A mos kërkon ai, që të gjithë zotat t'i bëjë një Zot të Vetëm? Vërtet që kjo është një gjë e çuditshme!**" (Sad, 5) Ibn Abasi ka thënë: "Për këtë ngjarje Allahu e zbriti këtë ajet kuranor..." Shënon Taberiu në *Tefsirin* e tij, 20/19.

Pra, nga ky transmetim kuptohet se sikur të ishte çështja e fjalës *La ilahe il-Allah* vetëm shqiptimi me gjuhë, nuk do të ngurronin politeistët mekas ta thoshin. Dhe, me kaq, do të zgjidhej kjo çështje. Porse, ata e kuptuan fare mirë përmbajtjen e kësaj fjale dhe kërkesat e saj: largimi nga të gjithë zotat që i adhuronin ata atëbotë në vend Allahut, distancimi prej tyre dhe adhurimi i Allahut, të Vetmit, Zotit të botëve.

E njëjta gjë vlen edhe për ata që mendojnë se, të jesh musliman, mjafton ta shqiptosh vetëm shehadetin dhe se me kaq mbaroka çdo gjë. Po të ishte realiteti i këtillë, shqiptimi i dëshmisë do t'u bënte dobi idhujtarëve të Mekës. Mirëpo, kjo fjalë kërkon shqiptim, besim dhe veprim sipas asaj që ka urdhëruar Allahu: adhurimin dhe nënshttrimin ndaj Tij në atë që ka kërkuar dhe largimi e distancimi prej asaj që Ai ka ndaluar.

Kapitulli: Llojet e adhurimit

Nëse i ke kuptuar këto baza dhe rregulla, dije se Allahu i Lartësuar për besimtarët ka bërë obligim disa lloje adhurimesh, si:

Adhurime të bindjes apo të besimit (ibadete itikadije), që janë thelbi i adhurimit. I këtij lloji është të besosh në Një Zot të Vetëm, të Cilit i takon Krijimi dhe se çdo gjë është në dorën e Tij; në dorën e Tij është dëmi dhe dobia, Ai është i Cili nuk ka rival, askush nuk mund të ndërmjetësojë tek Ai pa lejen e Tij dhe se Ai është i Vetmi që meriton të adhurohet, si dhe elemente të tjera që lidhen me këtë lloj adhurimi.

Adhurime që kanë të bëjnë me gjuhë apo me shqiptim, siç është shqiptimi i *fjalës së teuhidit (La ilahe il-Allah)*. Kështu që, ai i cili beson në atë që u përmend më sipër, por nuk e shqipton me gjuhë, nuk i ka të siguruara gjakun dhe pasurinë e tij. I tilli është sikurse Iblisi, i cili e ka besuar dhe e ka pranuar teuhidin, siç e cekëm më lart, mirëpo nuk iu nënshtrua urdhrit të

Allahut për t'i rënë në sexhde, rrjedhimisht mohoi (bëri kufër).

Pra, ai që e shqipton fjalën e teuhidit, por nuk i bindet asaj, i ka të pasiguruara pasurinë dhe gjakun e tij, e llogaria e tij është tek Allahu. Ndërkaq, gjykimi për të është sikur gjykimi për hipokritët (munafikët).¹

Adhurime trupore: siç është qëndrimi në këmbë, rukuja dhe sexhdeja në namaz. Gjithashtu, ndër to hyjnë: agjërimi, ritet e haxhillëkut, tavafi rreth Qabesë etj.

Adhurime me pasuri: siç është dhënia e një pjese të pasurisë (zekati), duke iu bindur urdhrorit të Allahut të Madhëruar.

Llojet e obligimeve dhe gjërave të pëlqyera, që kanë të bëjnë me trupin, me pasurinë, me veprat, me fjalët etj., janë të shumta, mirëpo këto që përmendëm janë ndër më kryesoret.

¹ Hipokrit (munafik) është ai i cili e fsheh kufrin (mosbesimin) në zemrën e tij, kurse në anën e jashtme e shfaq besimin.

Të dërguarit (pejgamberët) janë dërguar për ta njësuar Allahun në adhurim

Në qoftë se konfirmohen këto baza të besimit, që sapo u përmendën, dije se Allahu i Lartësuar ka çuar të dërguar, *alejhim selam*, që nga i pari e deri tek i fundit, t'i ftojnë njerëzit për ta njësuar Allahun në adhurim (ta adhurojnë vetëm Atë) e jo (vetëm) për të pranuar se Allahu i ka krijuar ata, apo diç të ngjashëm me këtë, kur dihet se ata e pranonin dhe besonin këtë gjë. Mu për këtë arsye ata thanë:

﴿ قَالُوا أَجِئْنَا لِنَعْبُدَ اللَّهَ وَحْدَهُ، وَنَذَرَ مَا كَانَ يَعْبُدُ آبَاؤُنَا ﴾ [الأعراف: ٧٠]

“A na ke ardhur që të adhurojmë vetëm Allahun e t'i lëmë zotat që kanë adhuruar prindërit tanë?” (Araf, 70)

Që ta njësojmë Atë në adhurim e t'i lëmë zotat tanë?! Pra, ata nuk mohuan gjë tjetër veçse kërkesën e të dërguarve që ta njësojnë vetëm Allahun në adhurim, andaj, adhuruan edhe zota të tjerë bashkë me Allahun e

Madhëruar; i bënë shok Atij, morën rival krahas Allahut, siç tregon Ai në Kuran:

﴿فَلَا تَجْعَلُوا لِلَّهِ أُنْدَادًا وَأَنْتُمْ تَعْلَمُونَ﴾ [البقرة: ٢٢]

“Prandaj mos sajoni me vetëdije zota të barabartë me Allahun.” (Bekare, 22)

Ata (idhujtarët) në thirrjen e haxhillëkut (në *telbije*) thoshin: *“Të përgjigjemi ty, o Allah, që je i Pashoq, përveç një rivali që është Yti, e posedon Ti atë dhe çka posedon ai.”* Kur i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, i dëgjonte teksa e thoshin këtë *telbije*, te fjala e tyre “i Pashoq”, u thoshte: *“Mjaft! Mjaft!”* Domethënë, njësojeni Allahun në adhurim. Sikur ta linit frazën *“... përveç një rivali që është Yti.”* Pra, e pranoin Allahun për Zot, por njëkohësisht i bënë shirk Atij. Allahu i Lartësuar në Ditën e Kiametit do t’u thotë:

﴿أَيْنَ شُرَكَاءُكُمُ الَّذِينَ كُنْتُمْ تَزْعُمُونَ﴾ [الأنعام: ٢٢]

“Ku janë zotat që i adhuronit.” (Enam, 22) Dhe:

﴿ وَقِيلَ ادْعُوا شُرَكَاءَكُمْ فَدَعَوْهُمُ فَلَمْ يَسْتَجِيبُوا لَهُمْ ﴾ [القصص: ٦٤]

“Thirrni hyjnitë tuaja.” -dhe ata do t’i thërrasin, por nuk do të marrin asnjë përgjigje.” (Kasas, 64) Dhe:

﴿ قُلْ ادْعُوا شُرَكَاءَكُمْ ثُمَّ كِيدُونِ فَلَا تُنظَرُونَ ﴾ [الأعراف: ١٩٥]

“Thuaj: “Thirrni zotat tuaj të rremë dhe kurdisni kurthe kundër meje, pa më lënë kohë.” (Araf, 195)

Pra, ortakëria ndaj Allahut dhe marrja rival krahas Tij e nënkuptojnë besimin e tyre dhe pranimin e Allahut për Zot. Kështu, ata i adhuruan idhujt duke iu nënshtruar e duke iu afruar me kurbane, për shkak të bindjes së tyre se kësisoj ata (idhujt) do t’i afronin tek Allahu dhe do të ndërmjetësonin për ta;¹ kështu që Allahu i Lartësuar i çoi të dërguarit e Vet për t’i urdhëruar këta njerëz ta lënë adhurimin e çdo gjëje në vend Allahut dhe se ky besim i

¹ Siç tregon Allahu i Lartësuar në Kuran: **“Sa për ata që marrin mbrojtës të tjerë, përveç Tij, duke thënë: “Ne u lutemi atyre vetëm që të na afrojnë tek Allahu.”** (Zumer, 3)

cili po ndiqni në këta idhuj dhe në këta rivalë është i padobishëm. Afrimi tek ata është i kotë dhe se një besim i këtillë duhet të jetë vetëm për Allahun, të Vetmin.

Ky pra është teuhidi i adhurimit, edhe pse ata e pranonin teuhidin *er-rububije*, që Allahu është i vetmi Krijues dhe Furnizues, siç është sqaruar më parë në *bazën e katërt*.

Nga sa u tha, bëhet e ditur se teuhidi në të cilin kanë ftuar të dërguarit, që nga i pari, Nuhu, *alejhi selam*, e deri tek i fundit, Muhamedi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, është teuhidi i adhurimit.

Ndaj, të dërguarit u thoshin:

﴿أَنْ لَا تَعْبُدُوا إِلَّا اللَّهَ﴾ [هود: ٢٦]

“... që të adhuroni vetëm Allahun.” (Hud, 26)

﴿أَعْبُدُوا اللَّهَ مَا لَكُمْ مِنْ إِلَهٍ غَيْرُهُ﴾ [الأعراف: ٥٩]

“Adhuroni Allahun, ju nuk keni zot tjetër përveç Tij.”

(Araf, 59)

Nga radhët e politeistëve (mushrikëve) kishte të atillë që i adhuronin engjëjt (melekët); i lutnin ata në kohë të vështira. Disa i adhuronin gurët; ndihmën e kërkonin prej tyre. Këta, gurët, në të vërtetë janë gdhendje (piktura) të disa njerëzve të mirë, që i donin dhe u besonin. Pastaj, kur ata vdiqën, i formësuan sipas dukjes së tyre. Kësisoj, pasi kaloi një kohë e gjatë, filluan t'i adhurojnë. Më pas, me kalimin e kohës, e filluan adhurimin e gurëve të tjerë. Prej tyre kishte të atillë që e adhuronin Mesihun (Isanë, të birin e Merjemes, *alejhima selam*); e disa i adhuronin yjet, i thirrnin për ndihmë në vështirësi.

Për këtë Allahu e dërgoi Muhamedin, *sal-lallahu alejhi ue selem*, që t'i ftojë ata për tek Allahu i Vetëm, ta njësojnë edhe në adhurim, ashtu siç e njësonin në krijim, fjala vjen, në krijimin e qiejve dhe të Tokës. Gjithashtu, ta njësojnë Atë me fjalën-formulën *La ilahe il-lAllah (Nuk ka zot që meriton adhurimin përveç Allahut)*, duke e besuar

bindshëm kuptimin e saj, duke punuar sipas saj¹ dhe mos ta lusin krahas Allahut askënd tjetër.

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿لَهُ دَعْوَةُ الْحَقِّ وَالَّذِينَ يَدْعُونَ مِنْ دُونِهِ لَا يَسْتَجِيبُونَ لَهُمْ شَيْءٌ﴾ [الرعد: ٤٤]

“Lutje e vërtetë është vetëm ajo drejtuar Atij (Allahut), e ata që u luten të tjerëve pos Tij, ata nuk u përgjigjen atyre në asgjë.” (Rrad, 14)

Dhe thotë:

¹ Ky është përkufizimi i imanit (besimit) te pasuesit e Sunetit dhe te dijetarët e hadithit. Imam El-Axhurri, *Allahu e pastë mëshiruar*, ka thënë: “Dijeni, Allahu na mëshiroftë, ne dhe ju, se dijetarët e muslimanëve kanë rënë në ujdi se imani (besimi) është obligim për të gjitha krijesat dhe se me të nënkuptohet: besim me zemër, pranim me gjuhë dhe veprim me gjymtyrë. Pastaj, dijeni se njohja dhe besimi me zemër nuk është i vlefshëm përderisa nuk e shpreh atë me gjuhë. Ndërkaq, besimi me zemër dhe shqiptimi me gjuhë nuk janë të vlefshme derisa të veprohet me gjymtyrë. Ai që është i pajisur me këto tri cilësi është besimtar. Për këtë tregon Kurani, Suneti dhe dijetarët e muslimanëve.” *Kitabu sheriah*, 2/260.

﴿ وَعَلَى اللَّهِ فَتَوَكَّلُوا إِن كُنتُمْ مُؤْمِنِينَ ﴾ [المائدة: ٢٣]

“Dhe vetëm Allahut mbështetjuni nëse jeni besimtarë të sinqertë.” (Maide, 23)

Pra, prej kushteve të besimit në Allahun është t'i mbështetet vetëm Atij, ta njësojë Atë në mbështetje (*tevekul*), siç duhet njësuar në dua, në lutje dhe në kërkimfalje.

Njashtu, Allahu i urdhëroi robërit e Tij të thonë:

﴿ يَا أَيُّهَا النَّبِيُّ ﴾ [الفاطحة: ٥]

“Vetëm Ty të adhurojmë.” (Fatiha, 5)

Rrjedhimisht, nuk mund t'i besohet dikujt që e thotë këtë fjalë pa ia kushtuar adhurimin vetëm Allahut, në të kundërtën i tilli është gënjeshtar dhe nuk është i denjë për ta thënë këtë fjalë. Kjo, për faktin se dihet kuptimi i saj, e që është: të veçojmë Ty në adhurim dhe të njësojmë në të. Ky pra është kuptimi i fjalës së Allahut **“Vetëm Mua më adhuroni!”** dhe **“Vetëm Mua më kini frikën!”**

që do të thotë adhurojeni vetëm Allahun dhe mos e adhuronit askënd tjetër krahas Tij; frikësojuni vetëm Allahut dhe mos iu frikësoni dikujt tjetër krahas Tij.

Pra, njësimi i Allahut në adhurim nuk plotësohet dhe nuk vlen pa qenë e tërë lutja vetëm për Allahun, thirrja për ndihmë në vështirësi dhe në rehati t'i drejtohet vetëm Allahut, të kërkohet mbrojtje dhe ndihmë vetëm prej Allahut, Atij t'i drejtohem dhe tek Ai të kthehem për çdo gjë, të pritet kurban vetëm për Të, e kështu me radhë të gjitha llojet e adhurimeve, si: nënshtrimi ndaj Allahut, përlulja, rukuja, sexhdeja, tavafi, heqja e rrobave gjatë ihramit, rroja dhe shkurtimi i flokëve, që të gjitha këto të jenë vetëm për Allahun.

Kushdo që ia kushton ndonjërin nga këto vepra ndonjë krijese të gjallë apo të vdekur, të ngurtë apo diçkaje tjetër, vetëm se ka bërë shirk në adhurim. Ndërkaq, ky të cilit (a kësaj gjëje së cilës) i kushtohet ndonjëri nga këto adhurime, shndërrohet në "zot" të adhuruesve të tij. E, i adhuruari (në këtë rast) mund të jetë engjëll (melek), i dërguar, njeri i mirë, dru, gur, varr, xhin, i vdekur apo i

gjallë. Ai që e bën këtë adhurim bëhet "rob" i kësaj krijese që e adhuron, edhe nëse ky e pranon dhe e adhuron Allahun, ngase besimi në Allahun nga ana e politeistëve (mushrikëve) nuk i ka nxjerrë nga shirku, as nga obligimi i vrasjes dhe derdhjes së gjakut të tyre, as nga robërimi i familjeve të tyre e as nga marrja e pasurisë së tyre. E tërë kjo për faktin se Allahu është Ai që nuk ka nevojë aspak për rival e nuk e pranon asnjë vepër në të cilën i bëhet ortakëri Atij dhe nuk ka besuar në Të ai që adhuron edhe dikë tjetër krahas Allahut.

Kapitulli: Nuk mjafton vetëm besimi në Zotin, po qe se nuk e adhurojmë Atë dhe nuk i largohemi shirkut

Tani më u vërtetua se idhujtarëve (mushrikëve) nuk u bëri dobi besimi në Allahun, për shkak të shirkut që i bënë Atij në adhurim. Ndaj, ky besim në Allahun është i pavlerë. Shirku i tyre ishte se besonin në idhuj: (kinse) ata (idhujt) u sjellin atyre dëm dhe dobi, i afrojnë tek Allahu dhe se ndërmjetësojnë për ta tek Allahu. Kështu, thernin kurbane për ta, bënë tavaf rreth tyre, përuleshin para tyre, u nënshtroheshin atyre, ishin në shërbim të tyre, u bënë sexhde.

Edhe pas tërë kësaj, këta politeistë (mushrikë) e besonin Allahun për Zot dhe Krijues të tyre (*teuhid er-rububije*). Mirëpo, meqë ata i bënë shirk Allahut në adhurim (në *teuhid el-uluhije*), kjo i bëri ata idhujtarë dhe nuk u solli dobi besimi i tyre në Allahun, ngase vepra e tyre ua përgënjeshtroi besimin, rrjedhimisht nuk u bëri dobi *teuhidi er-rububije*, të cilin e kishin.

E vërteta është se, ai që e beson *teuhidin er-rububije*, se Allahu është Zot dhe Krijues, duhet dhe obligohet ta njësojë vetëm Allahun në adhurim, e nëse nuk e adhuron

Atë, atëherë njësimi (*teuhidi er-rububije*) është i kotë, i papranueshëm.¹

Këta politeistë (mushrikë) do ta kuptojnë këtë gjë kur të jenë në zjarrin e Xhehenemit, ku do të thonë:

﴿ تَاللّٰهِ اِنْ كُنَّا لَفِي ضَلٰلٍ مُّبِيْنٍ ﴿٩٧﴾ اِذْ نُسُوْبِكُمْ رَبِّ الْعٰلَمِيْنَ ﴿٩٨﴾ ﴾ [الشعراء: ٩٧ -

[٩٨

“Betohemi për Allahun, ne kemi qenë njëmend në humbje të qartë, kur ju kemi barazuar me Zotin e botëve.” (Shuara, 97-98)

¹ Këto dyja janë gjëra të pandara (*teuhidi rububije* dhe *teuhidi uluhije*): njëra nuk pranohet pa tjetrën. Pra, ai që pranon se Allahu është Zot, Krijues, Furnizues, jep jetë dhe vdekje, se gjithçka është në dorën e Tij, atëherë medoemos duhet ta adhurojë vetëm Atë. Po qe se nuk e bën këtë, besimi i tij konsiderohet i pavlefshëm. Shumë njerëz në mesin e popullit tonë nuk e kanë kuptuar një gjë të këtillë. Shumë prej tyre i dëgjon tek thonë se unë besoj në Zotin e jam besimtar, mirëpo nuk e adhuron Allahun, nuk u bindet urdhrave të Tij, siç është namazi, agjërimi, zekati, haxhi, mbulesa për femrat, respekti ndaj prindërve etj. Të gjitha këto vepra janë adhurim ndaj Allahut, prandaj janë të domosdoshme për t'u quajtur musliman i vërtetë dhe për t'u pranuar besimi. Rianalizoje thënien e imam Axhurrit, që e cituam në fusnotën e pakmëparshme.

Edhe pse ata nuk e barazonin në të gjitha aspektet Allahun me idhujt; nuk i konsideronin idhujt krijues dhe furnizues të tyre, mirëpo kur të futen në gropën e zjarrit të Xhehenemit e kuptojnë se përzjerja e tyre me një grimcë shirku në adhurim i bëri ata të jenë sikurse ai i cili i barazon idhujt me Zotin e Gjithësisë. Allahu i Lartësuar thotë:

﴿ وَمَا يُؤْمِنُ أَكْثَرُهُمْ بِاللَّهِ إِلَّا وَهُمْ مُشْرِكُونَ ﴾ [يوسف: ١٠٦]

“Shumica e tyre nuk besojnë në Allahun, pa i shoqëruar atij njëkohësisht (idhuj të rremë) në adhurim.”¹ (Jusuf, 106)

Domethënë, shumica e tyre nuk beson në Allahun për Zot, Krijues të tyre, Krijues të qiejve dhe të Tokës, vetëm se

¹ Ibn Abasi, *radijallahu anhum*, duke e komentuar ajetin kuranor: **“Shumica e tyre nuk besojnë në Allahun, pa i shoqëruar atij njëkohësisht (idhuj të rremë) në adhurim.”** thotë: “Prej bindjeve të tyre ishte se kur u thuhej: Kush e ka krijuar qiellin? Kush e ka krijuar tokën? Kush i ka krijuar kodrat? Thoshin: ‘Allahu.’ Megjithatë ata janë politeistë, që i bënë shirk Atij, adhuruan dikë tjetër krahas Tij dhe, krahas Allahut, i bënë sexhde idhujve.” Shënon Taberiu, 13/375.

duke ia shoqëruar idhujt (duke qenë politeistë) në adhurimin e Tij.

Gjithashtu, Allahu i Lartësuar syfaqësinë në adhurime e ka quajtur “shirk” duke ditur se në të, vepruesi i kësaj vepre të syfaqësisë, nuk kishte për qëllim dikë tjetër përveç Allahut, porse përmes kësaj vepre apo adhurimi ai synonte pozitë dhe respekt në zemrat e njerëzve. Pra, ai që bën syfaqësi, e ka adhuruar vetëm Allahun, jo dikë tjetër, mirëpo adhurimin e tij e ka përzier me kërkim pozite të njerëzve, rrjedhimisht adhurimi i tij është i papranuar, ndaj Allahu këtë adhurim e quajti “shirk”, siç shënon imam Muslimi në *Sahihun* e tij, hadith ky i përcjellë nga Ebu Hurejra, *radijallahu anhu*, tek thotë:

“I Dërguari i Allahut, sal-lallahu alejhi ue selem, ka thënë: “Allahu i Lartësuar thotë: “Unë jam më se i panevojshëm për shirkun. Atë që bën një vepër duke më shoqëruar dikë tjetër, do ta lë, atë dhe shirkun e tij.”¹

¹ Shënon Muslimi në *Sahihun* e tij, 2985.

Po ashtu, Allahu e konsideroi shirk emërtimin e fëmijës me emrin AbdulHarith (Rob i Harithit). Allahu i Lartësuar thotë:

﴿ فَلَمَّا أَتَاهُمَا صَالِحًا جَعَلَا لَهُ شُرَكَاءَ فِيمَا آتَاهُمَا فَتَعَالَى اللَّهُ عَمَّا يُشْرِكُونَ ﴿١٩٠﴾ ﴾

[الأعراف: ١٩٠]

“Por, pasi Ai u dhuron pasardhës të shëndoshë e të mirë ata të dy i veshin Allahut ortakë në lidhje me atë që u kishte dhënë. Por Allahu është shumë lart nga ato që ia veshin Atij si ortakë.” (Araf, 190)

Imam Ahmedi dhe Tirmidhiu e shënojnë hadithin e përcjellë nga Semura ibn Xhundub, *radijallahu anhu*, se i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë:

“Pasi që Havaja ishte me barrë (sa herë që lindte, fëmijët nuk i mbijetonin), asaj i vajti Iblisi e i tha: “Nuk mbijeton asnjë fëmijë yti derisa ta emërtosh me emrin AbdulHarith

(Rob i Harithit). Ajo e emërtoi me këtë emër, fëmija mbijetoi. Pra, ky qe një inspirim dhe cytje nga shejtani."¹

Allahu i Lartësuar zbriti ajete në Kuran duke e emërtuar "shirk" një gjë të tillë. Ndërkaq, *Harith* ishte një nga emrat e shejtanit.² Ky tregim gjendet në *Ed-durul-menthur* dhe në libra të tjerë.

¹ Shënojnë Ahmedi, 5/11; Tirmidhiu, 3077; Taberaniu në *El-Kebir*, 6895; dhe Hakimi në *Mustedrekun* e tij, 2/545; ndërkaq Tirmidhiu thotë se ky hadith është *hasen garib*; Hakimi thotë se zinxhiri i tij është i saktë. Ibn Kethiri thotë: "T'i atribuohet ky hadith të Dërguarit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, është gabim. Në të vërtetë kjo thënie është e sahabiut." Albani këtë hadith e ka gjykuar si të dobët në *Silsiletu ed-daifeh*, 342.

² Rreth kësaj ka mospajtime, sepse hadithi i lartcekur është i dobët. E vërteta është se emri Harith është prej emrave më të mirë, siç është përcjellë nga i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, tek thotë: "Emrat më të mirë janë: *Abdullah, Abdurrahman dhe Harith*." Hadithin e shënon Ahmedi në *Musned*, 3/178, ndërkaq Albani e konsideron të saktë në *Sahih el-xhami*, 162.

Kapitulli: *Bindja në dikë (a në diçka) tjetër pos Allahut është shirk*

Tashmë u qartësua se, ai i cili beson se ndonjë dru, gur, varr, engjëll (melek), xhin, ndonjë i gjallë apo i vdekur, sjell dobi apo dëm, të afron me Allahun apo ndërmjetëson tek Ai për t'ua plotësuar ndonjë nevojë nga ato të dynjasë, vetëm se ka bërë shirk në Allahun, dhe se ka besuar në diçka që është e ndaluar të besojë, ashtu siç besonin politeistët e Mekës në idhuj, e aq më keq për atë që zotohet (bën *nedhër*)¹ me diçka nga pasuria apo fëmijët e tij, për të vdekurin apo për të gjallin dhe kërkon prej tij diç që i kërkohet vetëm Allahut të Lartësuar, për nevoja të ndryshme, si: shërimi i të sëmurit, gjetja e të humburit, apo plotësimin e ndonjë kërkese, **e tërë kjo**

¹ *Nedhri* është lloj zotimi apo kushtëzimi që dikush e bën për t'iu plotësuar nevoja që ka, si: Nëse Allahu më furnizon me fëmijë, do të agjëroj dy muaj pandërprerë, apo do të jap kaq lëmoshë nga pasuria etj. *Nedhri* është adhurim, që duhet kushtuar vetëm Allahut. Nëse i kushtohet dikujt tjetër, konsiderohet shirk.

është shirk në Allahun, shirk ky në të cilin kanë qenë adhuruesit e idhujve.¹

Pra, bërja *nedhër* për të vdekurin, me para apo me diç tjetër, prerja e kurbanit te varri i tij dhe marrja e tij për ndërmjetës, kërkimi i plotësimit të nevojave apo dëshirave nga ai, pikërisht ky është shirku i cili bëhej në kohën e *Xhahilietit*.² Kohanikët e *Xhahilietit* këtë lloj

¹ **Shejh Kasim El-Hanefiu** (dijetar i mdhhebit hanefi) në librin *Sherhu durer il-bihar* thotë: “Zotimi (nedhri) i vepruar sot nga shumë njerëz, siç është e njohur, që, kur ndokush ka ndonjë të humbur, të sëmurë apo ndonjë nevojë tjetër, shkon te varri i ndonjë njeriu të mirë dhe te koka e tij vë ndonjë mbulojë dhe i thotë: ‘O zotëria im! Nëse Allahu ma kthen të humburin, nëse më shërohet i sëmuri apo nëse më plotësohet nevoja ime, për ty do të jap kaq pasuri prej ari a prej argjendi, do të jap kaq ushqim, do të jap kaq ujë, kaq vaj etj., sipas konsensusit të muslimanëve është zotim i kotë për këto shkaqe: i kushtohet krijesës, **ndërkaq zotimi nuk lejohet të jetë i tillë**; ai është adhurim, ndërkaq adhurimi nuk u drejtohet krijesave; atij që po i kushtohet nedhri është i vdekur, ndërkaq i vdekuri nuk posedon gjë; **ai që zotohet mendon se i vdekuri i ka dorë në këto çështje përveç Allahut, e besimi i këtillë është kufër.**” *Fet’hul Mexhid, sherhu Kitabi teuhid*, f. 137-138.

² *El-Xhahilijeh* (apo Xhahiliet) quhet periudha para fillimit të dërgimit të Muhamedit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, dhe para shpalljes së Kuranit,

shirku që e bënin e quanin “idhull”, shirk ky të cilin e veprojnë varradhuresit (*kuburitë*)¹, edhe po që se e quajnë *uelij*,² varr apo vendlutje.

Kështu, emrat nuk çojnë peshë dhe nuk e ndryshojnë gjendjen. Porse, ajo që vjen në konsideratë është kuptimi i këtyre emrave, e kjo është në përputhje me logjikën dhe me fenë, si p. sh: ai që pi alkool dhe e emërton si *ujë*, ai nuk ka pirë tjetër veçse alkool, rrjedhimisht dënohet me dënimin që i takon konsumuesit të alkoolit, madje, ndoshta, edhe mund t'i shtohet dënimi për shkak se ka mashtruar në emërtim. Është vërtetuar në hadithe se do

periudhë në të cilën ishte përhapur shumë injoranca, mosbesimi dhe idhujtaria.

¹ *El-Kuburij* janë të gjithë ata që i adhurojnë varret, tyrbet, teqetë, shehët apo njerëzit për të cilët pretendojnë se janë të mirë dhe kinse mund t’u sjellin dëm e dobi apo edhe t’ua plotësojnë kërkesat që kanë.

² *Velij* (sh. evlija) d.m.th. i dashur i Allahut. Ky term (keq)përdoret nga varradhuresit. Me të emërtojnë ndonjë njeri që ka qenë i mirë kur ishte gjallë dhe besojnë se pas vdekjes së tij ka mundësi t’u sjellë dëm apo dobi. Besimi i këtillë është shirk që të nxjerr prej fesë islame. Rrjedhimisht, ai që beson në këtë mënyrë nuk është musliman.

të vijnë disa njerëz që pinë alkool dhe e emërtojnë atë me emra të tjerë.¹ Të vërtetën e ka thënë i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, sepse vërtet kanë ardhur njerëz të prishur që pinë alkool dhe e quajnë atë *nebidh* (lëng që del pas shtrydhjes së rrushit).

I pari që mëkatin e Allahut dhe hidhërimin e Tij e emërtoi me emra të dashur për dëgjuesit ka qenë Iblisi, *Allahu e mallkoftë*, kur i tha babait të njerëzimit, Ademit, *alejhi selam*:

﴿يَتَّأَدُّمُ هَلْ أَدُلُّكَ عَلَى شَجَرَةِ الْخُلْدِ وَمُلْكٍ لَّا يَبْلَىٰ﴾ [طه: ١٢٠]

“O Adem, a të të tregoj për pemën e përjetësisë dhe pasurinë e pambaruar?” Pra, pemën, në të cilën Allahu i

¹ Ebu Umameh El-Bahiliu thotë: “I Dërguari i Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: “Nuk do të ndërrohen ditët dhe netët derisa një grup i umetit tim ta pijë alkoolin duke i vënë emra të tjerë.” Shënon Ibn Maxhe, 3384; konfirmuar nga Albani në *Sahih el-xhami*, 7283. Për fat të keq, kjo kohë është e pranishme. Shumë muslimanë pinë alkool dhe e quajnë me emra të ndryshëm, si: birra, viski, shampanjë, verë etj. E lusim Allahun t'i udhëzojë muslimanët e devijuar dhe të na mbrojë ne prej këtyre veseve.

Lartësuar e ndaloi Ademin t'i afrohet, e emërtoi si “pemën e përjetësisë”, në mënyrë që ta joshte dhe ta nxiste Ademin t'i afrohej asaj. Kësisoj e mashtroi atë duke ia ndërruar emrin, të cilin Iblisi e shpiku vetvetiu, siç bëjnë sivëllezërit e tij, të cilët e pasuan atë, duke e emërtuar drogën (hashashin) apo pijet dehëse me emrin “gllënjë e kënaqësisë”. Apo siç e emërtojnë disa zullumqarë marrjen e padrejtë të pasurisë së robërve të Allahut si “art”, duke thënë: arti i vrasjes apo i vjedhjes, arti i akuzimit. E tërë kjo është padrejtësi (zullum), tek shtrembërohet fjala “zullum” me fjalën “art”, “rregull”, “edukatë” apo “kulturë”. Madje, disa vendin ku konfiskohet pasuria e njerëzve e emërtojnë si “depo grumbullimi”, apo disa të tjerë bëjnë hile në peshojë dhe e quajnë “arti i matjes dhe peshimit” etj.

E tërë kjo tek Allahu quhet *padrejtësi* dhe *armiqësi*, e këtë e di çdokush që e ka ndier aromën e Kuranit dhe Sunetit. E tërë kjo është marrë nga Iblisi, i cili “pemën e ndaluar” e emërtoi si “pemë e përjetësisë”.

Gjithashtu, emërtimi i varrit me emrin “tempull” apo “vendadhurim”, si dhe atë në të cilin ata besojnë duke e quajtur “uelij” (i dashur i Zotit), e ky nuk del asnjëherë nga emri “idhull” apo “idol”, ngase veprimi që bëjnë ata njerëz në vende të tilla janë të njëjtat veprime që i bënin mushrikët para Islamit tek idhujt dhe tek idolët e tyre, teksa bënin tavaf rreth tyre, siç bëjnë tavaf haxhilerët rreth Qabesë, shtëpisë së Allahut; duke i prekur dhe duke u fërkuar për ta, siç i prekin dhe siç i përshëndesin haxhilerët këndet e Qabesë; u drejtohen të vdekurve me fjalët të cilat përmbajnë mohim (*kufër*), si: mbështetem në Allahun dhe në ty, o *uelij* (ka për qëllim të vdekurin); e kështu duke thirrur (për lutje) ata (të vdekurit) me emrat e tyre kur gjenden në raste vështirësie.

Çdo popull e ka personin e veçantë që e lut. Kështu, banorët e Irakut¹ dhe Indisë e lutnin Abdul Kadir El-

¹ Përmenden disa vende islame në të cilat shirku që përhapur me të madhe në kohën kur jetonte imam Es-Sanani, *Allahu e mëshiroftë*, sa që pothuajse çdo vend kishte një varr të caktuar që i luteshin pronarit të tij për nevojat që kishin, për largimin e fatkeqësive, për shërimin e të sëmurëve, për furnizimin me fëmijë atyre që nuk kishin, thernin kurbane

Xhejlanin, banorët e Tehaimit në secilin vend të tyre kanë ndonjë person të caktuar që ia drejtojnë lutjen, duke thënë: *o Zejlai, o i biri i Axhilit*, e emra të tjerë të idhujve të tyre.

Banorët e Mekës dhe Taifit lutën: *O Ibn Abas*;¹ banorët e Egjiptit (Misrit) i drejtonin lutjet e tyre me: *O Rifai, o Bedevij*; banorët e El-Bekrive dhe El-Xhibalit lutnin: *O Eba Tajr*, banorët e Jemenit: *O Ibn Ulvan* etj.

Pra, në çdo fshat ka të vdekur që lutën dhe adhurohen; banorët e atyre vendeve u lutën atyre, i thërrasin për ndihmë, kërkojnë prej tyre t'u sjellin të mira dhe t'ua

për të, u zotoheshin, si dhe veprime të ngjashme shirku, të cilat padyshim e rrënojnë imanin (besimin) e njeriut.

¹ Është për qëllim djali i axhës së të Dërguarit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, Abdullah ibn Abasi, *radijallahu anhum*a, varri i të cilit gjendet në Taif, ku njerëzit luteshin, kërkonin prej tij atë që lejohet t'i kërkohe vetëm Allahut të Lartësuar. Kjo gjendje vazhdoi derisa Allahu i Lartësuar ia begatoi thirrjen në teuhid dhe largimin prej shirkut dijetarit të njohur Muhamed ibn Abdulvehab, *Allahu e mëshiroftë*; me ç'rast u zgjerua shteti i Arabisë Saudite, u përhap teuhidi, u rrënuan të gjitha varret që adhuroheshin, tempujt dhe idolët që gjendeshin në atë kohë.

largojnë të këqijat. Pikërisht kështu vepronin politeistët e periudhës paraislame me idhujt dhe me putat e tyre,¹ siç kemi thënë në vargjet:

¹ Dijetari i shquar **Hamed ibn Nasir El-Muamer Et-Temimi** në librin e tij *El-feuakih el-idhab fi reddi ala men lem juhakkim es-Sunnete uel-Kitab*, thotë: “Ndër mushrikët e sotëm (ata që i përmendi edhe autori më sipër) ka të atillë që, nëse përballet me ndonjë vështirësi, i lutet vetëm shehut të tij (evlijave të vdekur), e thërret vetëm emrin e tij, vajton para tij si fëmija para nënës së vet. Kur goditet me fatkeqësi dhe mjerim, thotë: ‘O Ibn Abas! O i dashur!’ etj. Ka edhe të atillë që, kur gënjejnë, betohen në Allahun, kurse kur e pohon të vërtetën, betohet në Ibn Abasin apo në dikë tjetër. Kështu, krijesa i ka zënë vend më të rëndësishëm në zemër sesa vetë Krijuesi.” Shejh El-Muamer vijon: “Ai që i merr për ndërmjetës të dërguarit apo dikë tjetër, si Ibn Abasin, Mahbubin apo Ebu Talibin, i lut ata, u mbështetet atyre, u kërkon t’u sjellin të mira dhe t’ua largojnë të këqijat, në kuptimin që njerëzit e lutin njëri-tjetrin, që ata (ndërmjetësit) ta lutin Allahun, siç janë ndërmjetësit për mbretërit e kësaj bote, që i lutin mbretërit për t’ua plotësuar nevojat njerëzve, duke shfrytëzuar pozitën dhe afërsinë që kanë këta ndërmjetës te mbreti, si dhe për shkak të edukatës së tyre që të mos hyjnë direkt te mbreti për t’i kërkuar, **shkurt e shqip, ai që merr ndërmjetës për tek Allahu në këtë mënyrë, është jobesimtar dhe politeist, ndaj pasuria dhe gjaku i këtij janë hallall.**” Dijetarët kur kanë cekur një gjë të tillë, kanë sjellë konsensus (*ixhma*). Autori i librit *Sherhul lkna* thotë: “Ai që merr ndërmjetës mes tij dhe Allahut, u mbështetet atyre, u lutet dhe kërkon prej tyre, me konsensus (*ixhma*), ka mohuar, ngase e këtu ishte praktika e adhuresve të idhujve, që thoshin: “**Ne u**

Me ta¹ rikthyen kuptimin e Suvasë, e bashkë me të

Jeguthën dhe Vedanë, e sa të këqij ishin ata;

*Me emrat e tyre kërkuan ndihmë kur qenë
në vështirësi,*

*Siç kërkon ndihmë nevojtarë nga i Domosdoshmi, nga i
Vetmi;*

Sa e sa kurbane kanë therur pranë tyre,

Prerë jo në emër të Allahut, haptas, me vetëdije,

*E sa bënin tavaf rreth varreve, atyre duke iu
drejtuar,*

E duke prekur shtyllat (këndet) e tyre me duar!

lutemi atyre vetëm që të na afrojnë tek Allahu.” (Ez-Zumer, 3) Me kaq mbaron dhe fjala e shejh El-Muamerit, duke e cituar këtë nga shejhul Islam IbnTejmije në *Fetuatë* e tij, 1/124-126.

¹ Janë për qëllim idhujt. Në këto vargje autori tregon se varradhuresit e kohës së tij tek adhuronin këta idhuj dhe pronarët e atyre varreve, e kanë ringjallur politeizmin që bënte populli i Nuhut, *alejhi selam*, ku ata kishin pesë emra të idhujve që adhuronin: Veda-në, Suva-në, Jeguth-ën, Jeuk-ën dhe Nesra-në.

Dialog me varradhuresin

Nëse (ai që bën këtë shirk) **thotë:** Vërtet kurbanin e kam therur për Allahun, ngase në të e kam përmendur emrin e Allahut.

Thuaji: Nëse kurbanin ka qenë për Allahun, përse e çove te dera e tempullit (varrit), tek ai që ti e favorizon dhe beson në të? A kishe për qëllim madhërimin e tij?

Nëse e pohon, thuaji: Atëherë, ky kurban nuk është për Allahun, ngase Allahut i shoqërove dikë tjetër. Nëse nuk kishe për qëllim ta madhëroje këtë varr, a doje ta ndotje derën e këtij tempulli (varri) me gjak apo t'i fëlliqje ata që hyjnë aty? Ti e di shumë mirë se ky nuk ishte qëllimi yt dhe se nuk ke vajtur përveçse për të parën (për ta madhëruar varrin, idhullin). Rrjedhimisht, nga shtëpia jote ke dalë vetëm për shkak të tij.

Po ashtu, lutja e tyre drejtuar atij (varrit), pa dyshim se është shirk, shoqërim i Allahut në adhurim. Ndonjëherë besojnë në disa njerëz të gjallë të prishur (fasikë); u drejtohen atyre me lutje kur janë në vështirësi e në

rehati. E, ky, që i drejtohen me lutje, qëndron në më të keqen, nuk përfill asgjë me të cilën Allahu i ka urdhëruar robërit e Tij besimtarë; nuk prezanton në xhuma e as në namazet me xhemat, nuk e viziton të sëmurin e as që përcjell ndonjë xhenaze, nuk e fiton pasurinë me hallall, e shtoja kësaj edhe pretendimin e tij se e di të fshehtë. Kështu, Iblisi tërheq turma njerëzish tek ai, njerëz këta në zemrat e të cilëve vetë ai (Iblisi) ua ka ndërtuar strofkën dhe aty i ka çelur të vegjlit e tij. Më pas, këtij njeriu i besojnë në shpifjet e pretenduara, e madhërojnë atë dhe e bëjnë të ngjashëm me Zotin e botëve! Mjerë mendjet ku kanë shkuar! Si u injoruan bazat e fesë!

﴿ إِنَّ الَّذِينَ تَدْعُونَ مِنْ دُونِ اللَّهِ عِبَادٌ أَمْثَلُكُمْ ﴾ [الأعراف: ١٩٤]

“Në të vërtetë, ata që iu luteni ju, në vend të Allahut, janë robër si ju.” (Araf, 194)

Shtrohet pyetja: Ata të cilët besojnë në varre, në evlija, në njerëz të prishur, në prijësit e tyre etj., a konsiderohen mushrikë sikurse ata të cilët besonin në idhuj (para Islamit)?

Them: Po, janë ashtu siç ishin ata. Kësisoj, ata janë të njëjtë në këtë pikë. Bile-bile, këta të sotmit ua kanë tejkaluar me besimin e tyre, me nënshtrimin dhe me robërimin ndaj zotave, kështu që nuk ka dallim mes tyre.

Nëse thua: Varradhuruesit (*kuburitë*) thonë se ne nuk i bëjmë shirk Allahut të Lartësuar, as nuk e përngjasojmë Atë me idhujt. Ndërkaq, drejtimi tek evlijatë dhe besimi në ta nuk është shirk.

Them: Po. Allahu i Lartësuar thotë:

﴿يَقُولُونَ بِأَفْوَاهِهِمْ مَا لَيْسَ فِي قُلُوبِهِمْ﴾ [آل عمران: ١٦٧]

“Thoshin me gojët e tyre atë që nuk e kishin në zemrat e tyre.” (Ali Imran, 167)

Mirëpo, kjo është injoranca që kishin në konceptimin e shirkut, sepse madhërimi që ia bëjnë evlijave dhe prerja për ta kurbane është shirk. Allahu i Lartësuar thotë:

﴿فَصَلِّ لِرَبِّكَ وَأَحْرَسَ﴾ [الكوثر: ٢]

“Ti falu dhe prej kurban për hir të Zotit tënd.”

(Keuther, 2)

D.m.th., në mënyrën urdhërore: falu për hir të Zotit tënd, e jo për dikë tjetër. Njashtu, thotë:

﴿فَلَا تَدْعُوا مَعَ اللَّهِ أَحَدًا﴾ [الجن: ١٨]

“... prandaj mos iu lutni askujt, krahas Allahut.” (Xhin, 18)

Tashmë e ke të ditur, nga ajo që kemi përmendur më lart, se Allahu syefaqësinë e ka quajtur “shirk”. Po kjo që sapo thamë tani?!

Pra, kjo që bëjnë për evlijatë e tyre është pikërisht ajo që bënin politeistët, andaj u quajtën “mushrikë”. Rrjedhimisht, kurrsesi nuk u bën dobi tek thonë: Ne nuk i shoqërojmë Allahut asgjë, ngase vepra e tyre ua përgënjeshtrojnë fjalët.

Nëse thua: Ata nuk janë të vetëdijshëm (janë injorantë - *xhahilë*) se me veprat që bëjnë bëhen idhujtarë.

Të them: Juristët islamë (*fukahatë*) në librat e fikhut, respektivisht në *Kapitullin e daljes nga feja (ride)* kanë përmendur se, ai që flet ndonjë fjalë mosbesimi (*kufri*), mohon (bën kufër), edhe nëse nuk ka për qëllim kuptimin e saj (*kufirin*). Kjo argumenton se ata nuk e kuptojnë realitetin e Islamit e as domethënien e teuhidit, rrjedhimisht u shndërroan në qafirë esenciale (*kufar kufren aslijen*). Ndërkaq, Allahu i Lartësuar i ka obliguar robërit e Vet ta njësojnë vetëm Atë në adhurim: **“E adhuroni vetëm Allahun.”** Të jenë të sinqertë, siç thotë:

﴿وَمَا أُمْرُوا إِلَّا لِيَعْبُدُوا اللَّهَ مُخْلِصِينَ لَهُ الدِّينَ﴾ [البينة: ٥]

“E megjithatë, ata qenë urdhëruar vetëm që të adhuronin Allahun me përkushtim të sinqertë.”
(Bejine, 5)

Ai që e lut Allahun ditën e natën, haptas e fshehtas, me frikë apo me dëshirë, por pastaj lut edhe dikë tjetër, krahas Tij, vetëm se ka bërë shirk në adhurim. Kjo për faktin se duaja (lutja) është adhurim. Allahu i Lartësuar lutjen e ka quajtur “adhurim”:

﴿ وَقَالَ رَبُّكُمْ ادْعُونِي أَسْتَجِبْ لَكُمْ إِنَّ الَّذِينَ يَسْتَكْبِرُونَ عَنْ عِبَادَتِي سَيَدْخُلُونَ

جَهَنَّمَ دَاخِرِينَ ﴿٦٠﴾ [غافر: ٦٠]

“Zoti juaj ka thënë: “Mu lutni Mua, Unë ju përgjigjem, e ata që nga mendjemadhësia i shmangen adhurimit (lutjes) ndaj Meje, do të hyjnë të nënçmuar në Xhehenem.” (Gafir, 60)

Nëse thua: Po qe se ata janë idhujtarë, atëherë obligohet të luftohen dhe të sillemi me ta siç është sjellë i Dërguari i Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selem*, me mushrikët.

Them: Këtë mendim kanë ndjekur një grup i dijetarëve, që thonë: “Është obligim, së pari, të thirren në teuhid dhe t'u bëhet e qartë se ajo çka ata janë duke besuar nuk u sjell dëm e as dobi dhe se tek Allahu nuk u vlen asgjë. Po ashtu, ata që po i adhuroni janë njerëz sikurse jeni ju dhe se ky besim në ta është shirk. Më tutje, nuk pranohet besimi në atë që kanë ardhur të dërguarit përveçse duke e lënë atë (shirkun), duke u penduar për të si dhe duke e njësuar teuhidin me besim dhe me vepër vetëm për Allahun e Lartësuar, të Vetmin.

Obligim i dijetarëve është t'ua sqarojnë se besimi në të cilin janë, si: zotimi (*nedhri*), kurbanet, tavafi rreth varreve, janë shirk, haram; dhe pikërisht kjo është ajo çfarë bën idhujtarët e periudhës paraislame me idhujt e tyre.

Nëse dijetarët ua qartësojnë këtë gjë kryetarëve e mbretërve, atëherë këta (kryetarët dhe mbretërit) obligohen t'i dërgojnë thirrësit e tyre te njerëzit, që t'i thërrasin në pastrimin e teuhidit. Atij që kthehet dhe pranon një gjë të tillë, i mbrohet gjaku, pasuria dhe familja e tij, kurse për atë që vazhdon në të (në shirk), Allahu e ka lejuar atë që ia ka lejuar të Dërguarit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, karshi idhujtarëve (mushrikëve).

Nëse thua: Kërkimi i ndihmës (*el-istigatheh*), është vërtetuar në hadithe se në Ditën e Gjykimit njerëzit kërkojnë ndihmë nga Ademi, babai i njerëzimit, pastaj nga Nuhu, nga Ibrahim, nga Musai, nga Isai, *alejhim selam*, e deri te Muhamedi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, pasi që secili prej tyre heq dorë nga kjo, është argument se kërkimi ndihmë nga dikush tjetër përveç Allahut nuk është gjë e urryer.

Them: Ky është keqkuptim, ngase kërkimi i ndihmës nga të gjallët në atë që ata kanë mundësi të ndihmojnë nuk është gjë e urryer dhe këtë nuk e ndalon askush.¹ Allahu i Lartësuar në tregimin e Musait, *alejhi selam*, me personin izraelit dhe me egjiptianin thotë:

﴿ وَدَخَلَ الْمَدِينَةَ عَلَى حِينٍ غَفْلَةٍ مِّنْ أَهْلِهَا فَوَجَدَ فِيهَا رَجُلَيْنِ يَقْتَتِلَانِ هَذَا مِنْ شِيعِنِهِ وَهَذَا مِّنْ عَدُوِّهِ فَاسْتَعَاذَهُ الْرَّيِّ مِنْ شِيعِنِهِ عَلَى الَّذِي مِّنْ عَدُوِّهِ فَوَكَرَهُ مُوسَىٰ فَقَضَىٰ عَلَيْهِ قَالَ هَذَا مِنْ

عَمَلِ الشَّيْطَانِ إِنَّهُ عَدُوٌّ مُّضِلٌ مُّبِينٌ ﴿١٥﴾ [القصص: ١٥]

“Dhe ai (Musai) hyri në qytet në një kohë të pahetuar prej banorëve të tij. Aty pa dy veta që rriheshin. Njëri ishte nga të vetët, kurse tjetri nga kundërshtarët, Ai i anës së tij i kërkoi ndihmë kundër armikut. Dhe Musai i ra me grusht, duke e vrarë.” (Kasas, 15)

¹ Dijetarët kanë përmendur se lejohet t’u kërkohet ndihmë krijesave vetëm nëse plotësohen tri kushtet: 1. Të jetë i gjallë; 2. Të jetë i pranishëm; dhe 3. Të ketë mundësi reale të zbatojë atë që i kërkohet.

Ndërkaq, ne po flasim për kërkimin e ndihmës nga ana e varradhuresve (*el-kuburij*) dhe të tjerëve, të cilët kërkojnë ndihmë nga evlijatë e tyre, duke u kërkuar atyre **gjëra të cilat nuk ka mundësi të ndihmojë askush përveç Allahut të Lartësuar**, si: shërimi i të sëmurit etj. Më e çuditshme se kjo është ajo çfarë bëjnë disa varradhures dhe adhurues të të gjallëve në të cilët ata besojnë: ua mundësojnë pjesëmarrjen në fëmijë, nëse jeton, disa e blejnë fëmijën në barkun e nënës, që të jetojë për ta (për evlijatë e tyre të gjallë), si dhe gjëra të tjera të këqija, të cilat as mushrikët e periudhës paraislame nuk i bënin.

Disa, që e kanë për detyrë mbledhjen e asaj çfarë u japin varradhuresit pronarëve të varreve, më kanë treguar se, një njeri kishte vajtur pranë një varri. Me vete kishte marrë paratë e stolitë e gruas së tij. Duke iu drejtuar të vdekurit në varr, kishte thënë: “Kjo është për zotërinë tim, gjysma e merit të vajzës sime. Ngase, kur e kam martuar atë, kam pasë vendosur që këtë (dhuratën) ta jap për të (për të vdekurin)!!! Këtë që bëjnë këta njerëz, nuk e bënin adhuruesit e idhujve, e këtë pa dyshim e

përfshin fjala e Allahut të Lartësuar, ku tregon gjendjen e idhujtarëve (mushrikëve):

﴿وَجَعَلُونَ لِمَا لَا يَعْلَمُونَ نَصِيبًا مِّمَّا رَزَقْنَاهُمْ ۗ تَاللَّهِ لَسُنُكَنَ ۗ عَمَّا كُتِبَ ۗ تَفَتَّرُونَ ﴿٥٦﴾﴾
[النحل: ٥٦]

“E nga ajo që Ne i furnizuar, ata u ndajnë një pjesë atyre (zotave) që nuk kuptojnë asgjë. Betohe për Allahun, patjetër do të merreni në pëgjegjësi për atë që trillonit.” (Nahl, 56)

Ndërkaq, kërkimndihma e njerëzve nga të dërguarit në Ditën e Gjykimit, tek e lutin Allahun e Lartësuar ta fillojë llogaritjen e njerëzve, në mënyrë që të lirohen nga ky qëndrim i vështirë, pa dyshim se është e lejuar. Me këtë kam për qëllim kërkimin e lutjes së Allahut nga njerëzit për njëri-tjetrin. Madje, i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, i kishte thënë Omerit, *radijallahu anhu*, teksa ky i fundit po udhëtonte për ta kryer umren: *"Mos na harro në lutjet e tua, o vëllai im!"*¹ Gjithashtu, Allahu i Lartësuar na

¹ Shënojnë Ahmedi, 1/29; Ebu Davudi, 1498; Tirmidhiu, 3562; Ibn Maxhe, 2894; El-Bezari, 119; Ebu Davud Et-Tajalisi, 10; Ibn Siniu në *Amelu el-jeumi uel-lejle*, 385. Imam Ebu Isa Et-Tirmidhiu thotë: “Ky

ka urdhëruar të lutemi për besimtarët e besimtare dhe të kërkojmë falje për ta, siç thotë në Kuran:

﴿وَالَّذِينَ جَاءُوا مِنْ بَعْدِهِمْ يَقُولُونَ رَبَّنَا اغْفِرْ لَنَا وَلِإِخْوَانِنَا الَّذِينَ سَبَقُونَا بِالْإِيمَانِ وَلَا تَجْعَلْ فِي قُلُوبِنَا غِلًّا لِلَّذِينَ آمَنُوا رَبَّنَا إِنَّكَ رَءُوفٌ رَحِيمٌ﴾ [الحشر: ١٠]

“Edhe ata që kanë ardhur pas tyre e thonë: “Zoti ynë, falna, ne dhe vëllezërit tanë, që besuan para nesh dhe mos lejo që në zemrat tona të ketë anjë të keqe ndaj atyre që besuan. Zoti ynë Ti je i Butë dhe Mëshirëplotë!” (Hashr, 10)

Umu Selim, radijAllahu anha, kishte thënë: "O i Dërguari i Allahut, bëj dua për shërbëtorin tënd, për Enesin."¹

hadith është i mirë, i sakt (hasen-sahih), konsideruar si i vërtetë nga autori i librit *Amelu el-jeumi uel-lejle*." Ndërkaq, si të dobët e konsideron shejh Ahmed Shakiri në *El-musned*, si dhe shejh Albani në *El-mishkat*, 2248.

¹ Enesi, radijallahu anhu, përcjell se Umu Selim i është drejtuar të Dërguarit, *sal-lallahu alejhi ue selem*: "Për Enesin, për shërbëtorin tënd (lute Allahun për të). Ai tha: "O Allah, shtoja pasurinë dhe fëmijët e tij dhe begatoje në atë që i ke dhënë." Shënojnë Buhariu, 6380; dhe Muslimi, 2480.

Gjithashtu, sahabët, *radjallahu anhum*, kërkonin nga i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, të lutej për ta kur ai ende ishte gjallë. E tërë kjo është e lejuar me konsensusin e të gjithëve.

Mirëpo, çështja është se kërkimndihma që varradhuresit ua bëjnë të vdekurve apo të gjallëve, të cilët, madje, as për veten e tyre nuk posedojnë dëm e as dobi, as jetë e as vdekje, as ringjallje, as shërim të të sëmurëve, as t'i kthejnë të humburit, as t'i ujitin tokat e tyre, as t'i bëjnë kafshët e tyre ta shtojnë qumështin, as t'i ruajnë ato prej mësyshit, e gjëra të tjera që kërkojnë prej tyre, gjëra këto që ka mundësi t'ua plotësojë vetëm Allahu i Lartësuar.

Këta janë ata për të cilët Allahu thotë:

﴿وَالَّذِينَ نَادَعُونَ مِنْ دُونِهِ لَا يَسْتَجِيبُونَ نَصَرَكَمَّ وَلَا أَنْفُسَهُمْ يَصْرُونَ﴾

[الأعراف: ١٩٧]

“Kurse ata që i adhuron, në vend të Allahut, nuk mund t’ju ndihmojnë as ju e as veten.” (Araf, 197)

Njashtu thotë:

﴿ إِنَّ الَّذِينَ تَدْعُونَ مِنْ دُونِ اللَّهِ عِبَادٌ أَمْثَلُكُمْ فَادْعُوهُمْ فَلْيَسْتَجِيبُوا لَكُمْ إِنْ

كُنْتُمْ صَادِقِينَ ﴿١٩٤﴾ [الأعراف: ١٩٤]

“Në të vërtetë, ata që iu luteni ju, në vend të Allahut, janë robër si ju.” (Araf, 194)

E si pra të kërkoen gjëra të tilla prej diçkaje që është e ngurtë¹ apo prej atij që është i gjallë. Madje, ky që është i ngurtë është më i mirë sesa i gjalli, ngase i ngurti nuk është i ngarkuar tek Allahu. Politeistët një gjë të tillë e bënin gjatë adhurimit të idhujve, e kjo gjë është pikërisht adhurimi.

Pasuritë që ua kushtojnë atyre, duke e ndarë një pjesë të saj për varrin, siç e ndajnë edhe një pjesë të arës së mbjellë duke e emërtuar atë me emër të caktuar (*telem*),²

¹ Janë për qëllim idolët, putat e idhujt prej guri apo prej druri, të cilëve u kërkojnë ndihmë dhe i adhurojnë.

² Siç shihet, varradhuresit, bashkëkohës të imam Es-Sananit, kishin shkuar aq larg me shirkun e tyre, saqë arat që mbillnin, një pjesë të saj ia kushtonin atij a këtij, qoftë ai i vdekur a i gjallë (të cilit i besonin dhe e adhuronin), duke e dhënë për të. Këtë e quanin *telem*.

ia kushtojnë të vdekurit. Kështu veprohet në disa vende të Jemenit. Gjithashtu, atyre u lënë një pjesë të pasurisë dhe të mirave të tyre. Kjo dhe të tjera, janë e njëjta gjë të cilën e vepronin idhujtarët, për të cilët Allahu i Lartësuar na ka treguar në Kuran, tek thotë:

﴿وَجَعَلُوا لِلَّهِ مِمَّا ذَرَأَ مِنَ الْحَرْثِ وَالْأَنْعَامِ نَصِيبًا فَقَالُوا هَذَا لِلَّهِ بِرَعْمِهِمْ

﴿وَهَذَا لِشُرَكَائِنَا﴾ [الأنعام: ١٣٦]

“Dhe nga ajo që Ai krijoi prej të lashtave dhe prej kafshëve shtëpiake, ata (idhujtarët) ndanë një pjesë për Allahun dhe thanë: “Kjo është për Allahun, siç mendonin ata, e kjo është e idhujve tanë.” (Enam, 136)

Gjithashtu, i Lartësuari thotë:

﴿وَيَجْعَلُونَ لِمَا لَا يَعْلَمُونَ نَصِيبًا مِمَّا رَزَقْنَاهُمْ تَاللَّهِ لَسْتُلْنَ عَمَّا كُنْتُمْ تَفْتَرُونَ﴾

[النحل: ٥٦]

“E nga ajo që Ne i furnizuar, ata u ndajnë një pjesë atyre (zotave) që nuk kuptojnë asgjë. Betohe për

Allahun, patjetër do të merreni në pëgjegjësi për atë që trillionit.” (Nahl, 56)

Pra, këta varradhures, me besimin e tyre injorant dhe në devijimin e të gjallëve që i adhuronin, ndoqën pikë për pikë rrugën e mushrikëve, duke besuar në ta atë që lejohet të besohet vetëm në Allahun e Lartësuar: duke ua kushtuar atyre një pjesë të pasurisë, duke udhëtuar për t'i vizituar ata, duke bërë tavaf rreth tyre, duke u përlulur pranë varreve të tyre, duke i lutur gjatë vështirësive, duke prerë kurbane për ta, të gjitha këto janë lloje të adhurimeve, siç u sqarua. E, nuk di a ka të atillë që edhe u bën sexhde atyre?

Nuk është çudi po qe se ndodh një gjë e tillë. Më ka treguar dikush, në të cilin kam besim, se ka parë prej tyre tek u binin në sexhde, te pragu i derës së varrit, veliut të tij, të cilit i drejtohet me madhërim dhe me adhurim. Gjithashtu, edhe betohen në emrat e tyre. Madje, ka prej tyre që, po qe se ndokush betohet në emrin e Allahut të Lartësuar, nuk ia pranon, ndërkaq, po u betua në emër të ndonjërit prej evlijave që ata i adhurojnë, ia pranon dhe i beson atij.

Bash kështu vepronin adhuruesit e idhujve, siç na njofton Allahu i Lartësuar për ta, tek thotë:

﴿ وَإِذَا دُكِرَ اللَّهُ وَحْدَهُ اشْمَأَزَّتْ قُلُوبُ الَّذِينَ لَا يُؤْمِنُونَ بِالْآخِرَةِ وَإِذَا دُكِرَ الَّذِينَ مِنْ

دُونِهِ إِذَا هُمْ يَسْتَبْشِرُونَ ﴿٤٥﴾ [الزمر: ٤٥]

“Kur përmendet vetëm Allahu, zemrat e atyre që nuk besojnë në botën tjetër neveriten, e kur përmenden të tjerët, përveç Allahut, ata menjëherë gëzohen.”
(Zumer, 45)

Ndërkaq, në hadith të vërtetë tregohet se:

“Ai që betohet, le të betohet në emër të Allahut, ose le të heshtë.”¹

Kur i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, dëgjoji një njeri duke u betuar në Latin dhe në Uzanë, e urdhëroi të

¹ Shënojnë Buhariu, 2679; dhe Muslimi, 1646.

rithotë: "*La ilahe il-Allah*"¹, gjë e cila tregon se ai njeri doli nga Islami duke u betuar në emër të idhullit,² ndaj i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, e urdhëroi ta ripërtërijë Islamin e tij, ngase me betimin e tij ai kishte

¹ Ngase, duke u betuar në idhull, ka bërë shirk me gjuhën e tij, andaj obligohet të ripastrohet nga kjo, duke e shqiptuar fjalën e teuhidit.

² Disa nxënës të dijës kanë çuar pluhur ndaj këtij gjykimi të imam Es-Sananit, që kishte nxjerrë për atë që betohet jo në emër të Allahut. Duhet ditur se, po qe se dijetari muxhtehid gabon, në dashtë Allahu, nuk qortohet, madje shpërblehet dhe se gabimi i tij është i falshëm. Në anën tjetër, nuk është vetëm imam Es-Sanani ai që ka thënë një gjë të tillë. Këtë e pohon edhe imam Ibnul Arabij El-Maliku, tek thotë: "Ai që betohet në idhuj me seriozitet, është qafir (jobesimtar); ndërkaq, ai që betohet duke qenë injorant apo me tallje, le të rithotë *La ilahe il-Allah*, në mënyrë që Allahu t'ia falë, si dhe ta drejtojë zemrën nga harresa duke e përkujtuar Atë, e gjuhën kah e vërteta duke e mohuar atë që ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në pakujdesi." Këtë e përmend hafidh Ibn Haxheri në *Fet'hul-Bari*, 8/612. Gjithashtu, Ibn Haxheri në *El-fet'h* 10/516; përmend se Ibn Batal përcjellë nga El-Muhlibi, thotë: "I Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, atë që u betua në Latin dhe në Uzanë, e urdhëroi të rithotë *La ilahe il-Allah*, nga frika se mos po vazhdon në atë që kishte thënë, rrjedhimisht ekziston frika se, pas besimit të tij, i prishen veprat për shkak të shqiptimit të kësaj fjale mosbesimi."

bërë kufër, siç e kemi vërtetuar këtë në librin *Subulus-Selam, sherh Bulugil meram* dhe në *Minhatul Gaffar*.

Nuk i vlen shehadeti, as namazi etj. atij që bën shirk

Nëse thua: Nuk është njësoj, sepse ata (varradhuresit) e shqiptojnë fjalën *La ilahe il-lAllah*, e i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë:

*"Jam urdhëruar t'i luftoj njerëzit derisa të thonë "La ilahe il-lAllah" (Nuk ka zot që meriton të adhurohet përveç Allahut). Nëse e thonë këtë, i kanë të siguruara nga unë gjakun dhe pasurinë e tyre, përveç në të drejtën e kësaj fjale."*¹

Njashtu, Usame ibn Zejdit i kishte thënë: *"A e vrave pasi që tha "La ilahe il-lAllah?!"*²

Ndërkohë, ata e falin namazin, agjërojnë, e japin zekatin dhe e kryejnë haxhillëkun, përkundër idhujtarëve të periudhës paraislame, që nuk e bënë këtë.

¹ Shënojnë Buhariu, 392; dhe Muslimi, 21.

² Shënojnë Buhariu, 4269; dhe Muslimi, 96.

Them: I Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: "Përveç në të drejtën e kësaj fjale (*La ilahe il-Allah*)."

Ndërkaq, e drejta e kësaj fjale është njësimi i Allahut në adhurim dhe në ibadet vetëm për Allahun e Lartësuar, kurse varradhuruesit nuk e kanë njësuar Allahun në këtë adhurim. Rrjedhimisht, atyre nuk u bën dobi shqiptimi i shehadetit, ngase shqiptimi i shehadetit bën dobi vetëm nëse i praktikohet kuptimi.

Kjo fjalë nuk u bëri dobi hebrenjve, ngase mohonin disa nga të dërguarit e tyre, e, gjithashtu, atij që e konsideron të dërguar dikë që nuk e ka dërguar Allahu, nuk i bën dobi kjo fjalë.¹

¹ Ngase, ai që e ka shqiptuar dëshminë, ka sjellë diçka që e prish vetë dëshminë: *Muhamedi është i dërguar i Allahut*. Pra, ai që, për dikë tjetër, përveç të Dërguarit të Allahut, dëshmon se është i dërguar, e ka mohuar Muhamedin, *sal-lallahu alejhi ue selem*, dhe ka dalë prej fesë, edhe po qe se tërë ditën e tërë natën e shqipton dëshminë *La ilahe il-Allah*, sepse e ka rrënuar bazën e kësaj fjale dhe ia ka prishur themelet, rrjedhimisht nuk ka dobi prej kësaj.

A nuk e ke vënë re se benuhanifët (pjesëtarë fisi) e thoshin dëshminë *La ilahe il-lAllah, Muhamed resulullah* dhe e falnin namazin, mirëpo, në anën tjetër thoshin se Musejleme është i dërguar, andaj shokët (sahabët) e të Dërguarit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, i luftuan dhe i robëruan ata?

Po ai i cili veliut të tij apo pronarit të ndonjë varri i atribuon cilësi të Zotit dhe i kthehet atij me lutje?

Kështu, Aliu, prijësi i besimtarëve, *radijallahu anhu*, i dogji me zjarr ithtarët e Abdullah ibn Sebes. Në njërën anë ata e thoshin dëshminë *La ilahe il-lAllah, Muhamed resulullah*, mirëpo në anën tjetër e tepronin në bindjet e tyre karshi Aliut, *radijallahu anhu*, saqë besonin se ai është zot, siç besojnë sot varradhuresit.

Pra, Aliu i dënoi me një dënim të paparë më parë, duke hapur gropa, ku në secilën gropë vuri zjarr, i hodhi ata dhe tha:

Sa herë të shoh ndonjë punë të shëmtuar,

*Do ta ndez zjarrin dhe do të thërras për t'i gropuar.*¹

Kjo ngjarje gjendet në *Fet'hul-Bari* dhe në libra të tjerë të hadithit dhe të sires.

Gjithashtu, umeti islam ka rënë në ujdi se, ai që e mohon ringjalljen, mohon (bën kufër) dhe vritet, edhe nëse thotë *La ilahe il-Allah*.² Po ai që i bën shok Allahut?!

¹ El-Humejdju shënon në *Musnedin* e tij, 1/244-245, n. 533, me zinxhir përkatës, përcjellë nga Ikreme, se ka thënë: "Kur Ibn Abasi u informua se Aliu i kishte djegur felëshuesit (*murtedët*), i kishte thënë: 'Po të isha në vendin tënd, do t'i vrisja, në përputhje me atë që ka thënë i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*: "Atë që e ndërron fenë, mbyteni." Nuk do t'i digjja, për shkak të asaj që ka thënë i Dërguari: "Askujt nuk i takon të dënojë dikë siç dënon Allahu (d.m.th. me zjarr)."

² Allahu i Lartësuar thotë: "E nëse ti (Muhammed) çuditësh (përse të përgënjeshtrojnë), është edhe më e çuditshme fjala e tyre: "A do të kemi krijim të ri (të ringjallëmi) pasi të jemi bërë dhé?" Këta janë ata që mohuan Zotin e tyre, që do të ndëshkohen me pranga në qafë. Pra, këta janë banorë të zjarrit ku do të qëndrojnë përgjithmonë." (Rad, 5) Pra, i tillë është dënimi i tyre.

Nëse thua: I Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, e qortoi Usamen për shkak se e vrau personin që *tha La ilahe il-Allah*,¹ siç është e njohur në librat e hadithit dhe të sires.

Them: Nuk ka dyshim se, jobesimtarit që e thotë këtë fjalë, i mbrohet gjaku dhe pasuria, derisa të bëhet e qartë diçka që bie në kundërshtim me të. Në lidhje me këtë Allahu i Lartësuar e ka zbritur ajetin:

﴿يَتَأْتِيهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا إِذَا ضَرَبْتُمْ فِي سَبِيلِ اللَّهِ فَتَبَيَّنُوا﴾ [النساء: ٩٤]

¹ Usame ibn Zejd, *radijallahu anhuma*, tregon: "I Dërguari i Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selem*, na dërgoi prej Harkasë drejt Xhuhejnes, për t'i luftuar ata. Aty mbërritëm herët në mëngjes, me ç'rast i morëm nën kontroll." Rrëfen më tutje: "Unë dhe një ensar u përpoqëm me njërin prej tyre. Pasi që iu vërsulëm, tha: 'La ilahe il-Allah!' Në këtë rast ensariu e lëshoi atë, kurse unë e godita me shtizë duke e vrarë. Pastaj, kur u kthyem, i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, dëgjoi për këtë gjë, ndaj më tha (duke më qortuar): "E vrave pasi që kishte thënë *La ilahe il-Allah?!*" I thashë: "O i Dërguari i Allahut! Ai e tha këtë nga frika." Sërish më tha: "E vrave pasi që kishte thënë *La ilahe il-Allah...?!*" Vazhdoi të ma përsëriste aq herë, saqë thashë me vete: ah, sikur të mos e kisha bërë një gjë të tillë." Sipas një motërzimi tjetër, Usames i kishte thënë: "A mos ia hape zemrën (që ta dish se e tha nga frika?!)" Shënojnë Buhariu, 4269; dhe Muslimi, 96.

“O ju që besuat, kur marshoni në rrugën e Allahut (për në luftë), të jini të matur (vërtetojini gjërat).”
(Nisa, 94)

Pra, Allahu i Lartësuar i urdhëroi besimtarët ta vërtetojnë dhe ta qartësojnë çështjen e atij që e dëshmon fjalën e teuhidit. Kështu, nëse prej tij e qartësojmë përmbajtjen e asaj fjale, për të vlen ajo që vlen për muslimanët dhe, njëherazi, kundër tij vlen ajo që vlen kundër muslimanëve (i tilli konsiderohet musliman). Por, nëse për të vërtetohet e kundërta e kësaj fjale, atëherë vetëm shqiptimi i saj nuk ia mbron gjakun e as pasurinë. Kështu pra, çdokush i cili e shfaq teuhidin është obligim të ndalemi e të matemi karshi tij,¹ përveç nëse bëhet e qartë e kundërta e kësaj.

Siç e cekëm më lart, kjo fjalë nuk u bëri dobi hebrenjve e as havarixhëve, me gjithë adhurimet e shumta që bënin.

¹ Pra, ai që e shfaq teuhidin me gjuhë apo me gjymtyrë, nuk lejohet të dëmtohet, as të vritet e as t'i preket pasuria, ngase nga pamja e jashtme konsiderohet musliman.

Madje, i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, urdhëroi që të vriten ata, tek thotë:

*"Po qe se do t'i arrija, do t'i luftoja sikurse popullin e Adit."*¹

E kjo për faktin se ata kundërshtuan një pjesë të shariatit, andaj të vrarët e tyre janë më të këqijtë e këtij nënqielli, siç është vërtetuar në hadithe.

Pra, u bë e qartë se vetëm shqiptimi i fjalës së teuhidit nuk ia pamundëson vërtetimin e shirkut atij që e thotë, e kjo për shkak të veprimit të tij atë çka e kundërshton këtë fjalë, siç është adhurimi i dikujt tjetër përveç Allahut.

Nëse thua: Varradhuruesit, dhe të tjerët që besojnë në njerëz të prishur dhe në injorantë të gjallë nga mesi i tyre thonë se, ne nuk i adhurojmë ata, ngase nuk adhurojmë dikë tjetër krahas Allahut, të Vetmit. Pra, ne nuk falemi e as nuk agjërojmë për ta.

¹ Shënojnë Buhariu, 4591; dhe Muslimi, 3025.

Them: Kjo është injorancë në konceptimin e adhurimit. Adhurimi nuk është i kufizuar vetëm në atë që sapo përmende. Madje, thelbi dhe gjëja kryesore e tij është bindja apo besimi. E, në zemrat e tyre pikërisht kjo ka ndodhur, saqë atë e emërtojnë si “besim” a “bindje” dhe këtij termi i shtojnë gjëra të tjera, për të cilat është diskutuar më lart, gjëra këto që janë degë të këtij besimi, si: lutja e tyre, thirrja, marrja e tyre për ndërmjetës, kërkimndihma e kërkimshpëtimi prej tyre, betimi, zotimi atyre (*nedhri*) etj.

Dijetarët kanë cekur se ai që vesh rroba të qafirëve, vetëm se është bërë qafir;¹ ai që shpreh fjalë mosbesimi

¹ Ibn Omeri, *radijallahu anhu*, tregon se i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë “Jam dërguar me shpatë para Kiametit derisa të adhurohet vetëm Allahu i Lartësuar e i Pashoq. Rrishtu më është dhënë nën hijen e shtizës sime. Qoftë i nënçmuar dhe i poshtëruar ai që e kundërshton çështjen time! Ai që i ngjan një populli, është prej tyre (i tillë).” Shënojnë Ahmed, 2/50; Ebu Davudi, 4031. Albani e konfirmoi si të saktë në *Sahih ul-xhami*, 2831.

Shejhul-Islam Ibn Tejmije në lidhje me këtë thotë: “E pakta që mund të merret prej këtij hadithi është ndalimi i përngjasimit me jobesimtarët (me qafirët). Që në shikim të parë vetëkuptohet mohimi (kufri) i atij që u

(kufri), bëhet femohues.¹ Po ai që e ka arritur këtë gradë bindjeje, fjale dhe vepre?

ngjan atyre, siç qëndron në fjalën e Allahut: **"E kush prej jush i miqëson ata, ai është prej tyre."** (El-Maide, 51) Ky është edhe kuptimi i asaj që do të citojmë prej Abdullah ibn Omerit, që ka thënë: "Ai që në tokë të politeistëve (mushrikëve) ndërton, kryen festat a manifestimet e tyre dhe u përngjan atyre derisa të vdesë, në Ditën e Kiametit do të ringjallet me ta." Kjo mund ta përmbajë përngjasimin e plotë me ta, ndaj një gjë e tillë e obligon kufrin. Gjithashtu, ai e përmban ndalimin e pjesërishëm të këtij përngjasimi, ndaj mund të përfshijë atë aq sa u ngjan atyre. Rrjedhimisht, po qe se përngjasimi është kufër, mëkat apo shenjë e tyre, atëherë edhe dispozita e tij është e këtillë." *El-Iktida*, 1/241-242.

¹ I Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: "Me të vërtetë, ndodh që robi shpreh ndonjë fjalë, përmbajtjen (kuptimin) e së cilës nuk ia di, porse fundoset për të në Zjarr më thellë sesa distanca mes Lindjes dhe Perëndimit." Shënojnë Buhariu, 6477; dhe Muslimi, 2988; i cili e shënon me këtë tekst: "Me të vërtetë, ndodh që robi shpreh ndonjë fjalë me të cilën e hidhëron Allahun, duke mos ia vënë veshin se ç'thotë, porse për të përmbytet në Xhehenem."

Prerja e kurbanit dhe zotimi (*nedhri*) lejohen vetëm për Allahun

Nëse thua: Ç'dispozitë kanë kurbanet dhe pasuria që u kushtohet atyre (*nedhri*)?¹

Them: Çdokush që ka logjikë e di se pasuria është gjë e shtrenjtë te njerëzit; nxitojnë në grumbullimin e saj, qoftë edhe duke i bërë të gjitha mëkatet, e shtegtojnë botën fund e krye. Ndaj, askush nuk e jep pasurinë e tij vetëm se me bindjen dhe me besimin se kësaj do të ketë më shumë dobi prej saj apo do t'i largojë ndonjë të keqe. Kështu që, ai i cili lë pasuri te ndonjë varr, vepron kështu vetëm për këtë qëllim. Ky besim është i kotë. Ndërkaq, ky, që lë këtë pasuri, sikur ta dinte kotësinë e kësaj lënieje, nuk do ta jepte as edhe një cent, ngase paraja është gjë e shtrenjtë për ata që e posedojnë.

¹ Është për qëllim pasuria që njerëzit lënë te varret apo te tyrbet, duke besuar se kjo u sjell dobi, se u jep suksese në jetë, se ua ruan familjen, se i furnizon me fëmijë, se u shërohet i sëmuri etj. Që të gjitha këto janë shirk ndaj Allahut të Lartësuar, ngase ato nuk lejohet t'i kërkohen dikujt tjetër krahas Allahut, siç është sqaruar më parë.

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿لَا يَسْتَأْذِنُكُمْ أَمْوَالُكُمْ﴾ ^(٣٦) إِنَّ يَسْتَأْذِنُكُمْ فِي حِفْظِهَا فَيُخْفِكُمْ تَبَحَّلُوا وَخُجِرَ أَضْعَانَكُمْ ^(٣٧)

[محمد: ٣٦ - ٣٧]

“... dhe nuk do të kërkojë prej jush pasurinë tuaj. Sikur ta kërkonte prej jush tërë pasurinë me këmbëngulje, ju do të bëheshit koprracë dhe, Ai do të nxirrte në shesh urrejtjen tuaj.” (Muhamed, 36-37)

Pra, ai që u lë pasuri varreve apo tyrbeve është obligim ta dijë se një gjë e tillë është humbje e pasurisë së tij dhe se kjo gjë nuk i bën dobi e as që ia largon të keqen. Ndërkaq, i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë:

*"Zotimi (nedhri) nuk sjell mirësi, e del nga koprraci."*¹

Kjo pasuri që jepet është obligim t'i kthehet pronarit të vet, kurse mbledhësi i saj e ka haram atë, ngase e ka ngrënë pasurinë e tjetrit pa të drejtë e pa asnjë mundim. Allahu i Lartësuar thotë:

¹ Shënojnë Buhariu, 6608; dhe Muslimi, 1639.

﴿ وَلَا تَأْكُلُوا أَمْوَالَكُمْ بَيْنَكُمْ بِالْبَاطِلِ ﴾ [البقرة: ١٨٨]

“Mos ia merrni pasurinë njëri-tjetrit padrejtësisht.”
(Bekare, 188)

Rrjedhimisht, ky mbledhës është pajtuar me shirkun e tij, me besimin e tij të kotë dhe është shprehur i kënaqur me të. E, askujt që kënaqet me shirkun nuk i fshihet.¹ Allahu i Lartësuar thotë:

﴿ إِنَّ اللَّهَ لَا يَعْزُبُ عَنْ يَشْرِكِ بِهِ ﴾ [النساء: ٤٨]

“Vërtet, Allahu nuk fal që të adhurohet dikush apo diçka tjetër veç Atij.” (Nisa, 48)

¹ Ai që kënaqet me kufirin apo me shirkun është qafir, mushrik, edhe nëse, në përjashtim të kënaqjes me zemër, nuk vepron asgjë të këqillë. Bedër Er-Rashidi në librin e tij *Elfadhul kufri* thotë: "Ai që qesh duke u pajtuar me atë që shpreh fjalë kufri, veçse bën kufër."

Kjo është e njëjtë me paratë që i merr fallxhori apo me pagesën që e merr lavirja,¹ kështu që, mbledhësi i këtyre parave, që u kushtohen të vdekurit, e ka mashtruar atë që jep, duke manipuluar me të se ai që gjendet në varr do t'i sjellë dobi apo dëm.

Pra, a ka më pajtim me të keqen sesa të mbledhësh para për të vdekurin? Cili mashrim është më i madh sesa ky? Cila kënaqje me mëkatin e madh është më e qartë se kjo? Cili shndërrim i së keqes në të mirë është më i çuditshëm sesa ky?

Përkushtimi i idhujtarëve të periudhës paraislame ndaj idhujve dhe ndaj putave bëhej pikërisht në këtë mënyrë. Kështu, ai që e jep pasurinë beson se ata idhuj sjellin të mira dhe i largojnë të këqijat, ndaj atyre u jep një pjesë të pasurisë, apo u ndan diç të veçantë. Gjithashtu, me vete sjell kurbane duke i therur pranë derës së idhullit.

¹ Ebu Mesud El-Ensariu, *radijallahu anhu*, përcjell se i Dërguari i Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka ndaluar të përfitohet prej qenit; prej parasë që merr lavirja, si dhe prej asaj që merr fallxhori. Shënojnë Buhariu, 2237; dhe Muslimi, 1567.

Mu për këto vepra Allahu i Lartësuar i ka çuar të dërguarit, në mënyrë që t'i heqin, t'i fshijnë, t'i rrënojnë dhe të ndalojnë prej këtyre gjërave.

Nëse thua: Ai i cili jep pasurinë në këtë mënyrë (duke u zotuar pranë varreve apo pranë idhujve), ka raste kur e arrin atë që e ka dëshiruar apo i largohet ndonjë e keqe për shkak të zotimit të bërë.

Them: Kështu, edhe prej idhujve të periudhës paraislame ndodhte që njerëzit arrinin më shumë se kjo, siç është të folurit nga brendia e tyre, si dhe shpalimi i ndonjë gjëje që fsheh njeriu. Kësisoj, nëse kjo është argument për vërtetësinë e varreve dhe besimin e bindjen në to, atëherë le të jetë argument edhe për vërtetësinë e idhujve. Kjo, padyshim, është shkatërrim i Islamit, përforsim i themeleve të idhujve dhe vërtetim se Iblisi me ushtrinë e tij, njerëz e xhinë, kujdesen më së shumti për humbjen e robërve.

Allahu i Lartësuar ia ka mundësuar Iblisit të hyjë në trupat e njerëzve dhe t'u fusë vesvese e dyshime në zemra,¹ t'ua gëlltisë zemrat përmes hundës së tij. Gjithashtu, mund të futet edhe në brendi të idhujve dhe të flasë nga brenda, që njerëzit ta dëgjojnë atë. Të njëjtën gjë e bën edhe tek ata që besojnë në varre, ngase Allahu i Lartësuar i ka dhënë leje, që me ushtrinë e tij t'i tërheqë pas vetes të bijtë e Ademit dhe t'i shoqërojë ata në pasuri dhe në fëmijë.²

Po ashtu, është vërtetuar në hadithe se shejtanët vjedhin diç të asaj që dëgjojnë nga melekët teksa Allahu i Lartësuar përcakton ndonjë gjë dhe u tregon atyre. Më pas, këta shejtanë, u tregojnë fallxhorëve atë që kanë dëgjuar. Pra, shejtanët janë ata që u tregojnë atyre diç

¹ Siç tregohet në hadithin e të Dërguarit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, tek thotë: "Vërtet shejtani qarkullon në trupin e njeriut siç qarkullon gjaku në të." Shënojnë Buhariu, 7171; dhe Muslimi, 2175.

² Siç thotë i Lartësuari në Kuran: "**Bëj për vete me zërin tënd (o Iblis) kë të mundesh prej tyre! Lësho kundër tyre kalorësinë dhe këmbësorinë tënde! Përzieju me ta në pasuri dhe në fëmijë dhe jepu premtime. Po premtimet e djallit janë vetëm mashtrime.**" (El-Isra, 64)

nga gjërat e fshehta, pastaj ata (falltarët), nga ajo që sapo marrin nga shejtanët, shtojnë edhe njëqind gënjeshtër.¹ Pastaj, shejtanët xhinë u drejtohen shejtanëve njerëz, që janë rojtarë varresh dhe të të tjerëve, me gënjeshtër e kotësi dhe u thonë varradhuresve: “Filan veliu ka bërë kështu e ashtu.” Kësisoj njerëzit i shtyjnë drejt atij dhe ua tërheqin vërejtjen nëse largohen prej tij. Rrjedhimisht, sheh edhe mbretër vendesh e prijës rajonesh duke pranuar një gjë të tillë; i miqësojnë punëtorët dhe mbledhësit e zotimeve (*nedhreve* - paratë që lënë njerëzit në varre apo në tyrbe). Ndonjëherë mbledhjen e tyre e merr përsipër ndokush për të cilin njerëzit kanë mendim të mirë, si: ndonjë dijetar, gjykatës, myfti, sheh i sufive,

¹ Aishja, *radijallahu anha*, përcjell se e ka dëgjuar të Dërguarin, *sal-lallahu alejhi ue selem*, duke thënë: “Vërtet melekët (engjëjt) zbresin në retë e qiellit tek flasin ndonjë çështje që është përcaktuar në qiell, porse atë ua vjedhin shejtanët për t’ua treguar fallxhorëve. Më pas, këta të fundit, të sapodëgjuarës ia mvëshin njëqind gënjeshtër nga vetvetja.” Shënojnë Buhariu, 3210; dhe Muslimi, 2228.

me ç'rast përforcohet edhe më tepër mashtrimi i Iblisit dhe kënaqet syri i tij me këtë pështjellim.¹

¹ Siç ngjet edhe në disa vende tonat, saqë, ata që i mashtrojnë njerëzit, i sheh duke u marrë para dhe pasuri atyre. Të këtillët, në mesin e njerëzve, hiqen si të ditur e si hoxhë filani; siç njihen edhe ata që rrinë nëpër tyrbe, si sheh filani. Kështu, te njerëzit konsiderohen si të mëdhenj, ngase të gjerët nuk e kuptojnë se në të vërtetë ata janë gënjeshtarë dhe mashtrues që ua hanë pasurinë pa të drejtë, në emër të fesë, të hajmalive apo të gjërave të këtilla të pabaza.

Përhapja e ndonjë të keqeje nuk është tregues saktësie

Nëse thua: Kjo dukuri i ka përfshirë të gjitha vendet, me të janë pajtuar të gjithë vendësit, Lindje e Perëndim, saqë s'ka asnjë vend islam që s'ka varre, teqe apo tyrbe. Njerëzit besojnë në to, i madhërojnë, u lënë para, i thërrasin me emrat e tyre, betohen në to, bëjnë *tavaf* rreth tyre (u rrotullohen sikurse haxhilerët rreth Qabesë), u ndezin qirinj, u recitojnë vargje e lexime të veçanta, i stolisin me mbuloja. Në këtë mënyrë ua kushtojnë çdo adhurim që kanë mundësi, si: madhërimi, nënshtrimi, përkulja, frikërespekti ndaj tyre etj.

Madje edhe shumica e xhamive të muslimanëve nuk janë kursyer nga varret, qofshin ato brenda a afër tyre. Në to ka edhe tyrbe të caktuara, në të cilat njerëzit hyjnë gjatë kohëve të namazeve (para a pas tyre); aty i kryejnë adhurimet që sapo i përmendëm. Si mund ta logjikojë ai që ka mend se një gjë e tillë që është aq e urryer dhe arrin në atë gradë aq të keqe e të shëmtuar, e të heshtin

kundrejt saj dijetarët islamë që janë të besueshëm në të gjitha anët e globit?!

Them: Nëse e dëshiron të drejtën dhe e lë anash pasimin e atyre që kanë kaluar, e kupton se e vërteta është ajo që bazohet në argumente e jo në atë që njerëzit e rëndomtë janë pajtuar brez pas brezi e vend pas vendi.

Dije se këto gjëra, rreth të cilave po sillemi dhe po ecim në shkatërrimin e simboleve të tyre, janë pasojë e njerëzve, Islami i të cilëve është pasimi pa argument i paraardhësve të tyre. Pasim i atyre që s'bëjnë dallim mes të mirës dhe të keqes.

Kështu, ndonjëri prej tyre rritet në atë mes e i sheh bashkëvendësit dhe të afërmit e tij tek i diktojnë qysh në fëmijëri ta thërrisë emrin e atij në të cilin ata besojnë. Më tej, i njëjti sheh se si ata i bëjnë *nedhër* dhe e madhërojnë atë, e dërgojnë këtë të shkretë te varri i veliut, e (për)lyejnë me dheun e tij, bëjnë *tavaf* bashkë me të rreth varrit. Kësisoj, i tilli rritet në këtë mënyrë, ndërkaq në zemrën e tij i është skalitur madhërimi i asaj që ata e madhërojnë dhe kjo, tek ai, është gjëja më e madhe.

Pra, në këtë gjendje fëmija rritet, e plakët i rrituri, pa dëgjuar askë që tërheq vërejtjen kundrejt saj. Madje, ka të atillë që pretendojnë se kanë dije, se janë të ndershëm, ndoshta ushtron detyrën e ndonjë gjykatësi, myftiu,¹ mësimdhënësi; apo ka ndonjë post në ndonjë zonë apo qeveri, ndërsa në anën tjetër i madhëron këto bestytini që ata i madhërojnë, i nderon ato që ata i nderojnë, merr *nedhrin* e tyre, ha kurbanet që theren nëpër varreza, duke menduar se i tillë është Islami dhe se kinse këto gjëra janë baza dhe kulmi i fesë.

Askujt që ka mendje dhe sadopak dije nga Kurani dhe Suneti nuk i fshihet fakti se *heshtja e hoxhës a dijetarit*

¹ Shejh Abdulaziz Raxhiu thotë: “Është fatkeqësi të ketë hoxhallarë a dijetarë të shirkut, që i stimulojnë njerëzit t'i bëjnë shirk Allahut. Të tillëve fjala nuk u merret parasysh, ngase parasysh merret vetëm fjala e hoxhallarëve të shariatit, që e thonë të vërtetën, bazuar në Kuran dhe në Sunet, që kanë dituri dhe punojnë sipas saj. Ndërkaq, hoxhallarët e devijuar nuk vlejnë gjë, sepse edhe hebrenjtë dhe të krishterët kanë dijetarë, ama të humbur.” (*Teufiku Rabil ibad, fi sherhi Tat'hiril itikad*, f. 127)

dhe e botës në tërësi kundrejt një të keqeje, nuk është argument i lejimit të asaj të keqeje.

Ta ilustrojmë me një shembull:

Tatimet dhe taksat, ndalesa e të cilave është çështje e njohur dhe themelore në fe,¹ janë përhapur në të gjitha vendet dhe janë bërë gjë e zakonshme, ndalimi i tyre nuk u hyn dot njerëzve në vesh; duart e taksambledhësve janë shtrirë edhe në tokën më të ndershme, në Mekë

¹ Edhe tatimet e doganat pa të drejtë, përfshihen **në ngrënien e pasurisë së njerëzve padrejtësisht**. Allahu i Lartësuar në Kuran thotë: **“Mos ia merrni pasurinë njëri-tjetrit padrejtësisht.”** (El-Bekare, 188) Gjithashtu, argumente tjera tregojnë se *el-muks* (doganat dhe tatimet) janë mëkate më të këqija se zinaja, Allahu na ruajt, siç tregohet në hadith, që një grua u gurëzua në kohën e të Dërguarit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ngase kishte bërë *zina*. Me ç’rast, kur një pikë nga gjaku i saj e spërkati fytyrën e Halid ibn Velidit, ky i fundit e ofendoi, kurse i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, e qortoi duke i thënë: *“Kujdes, o Halid! Për Atë, në dorën e të cilit është shpirti im, kjo është penduar aq shumë, saqë, edhe atij që ua merr doganat njerëzve (sahibul muksi), po të pendohej kësisoj, do t’i falej.”* Shënon Muslimi, 1695.

(Umul Kura), ku merren taksa nga haxhilerët teksa e vizitojnë Qabenë për ta kryer obligimin e Islamit (haxhillëkun).

Po ashtu, në këtë vend kryhet çdo punë e keqe, ndërsa banorët e saj, e që në mes tyre ka të ndershëm, të mençur, dijetarë, prijës, megjithatë i sheh të heshtur, ua kanë kthyer shpinën dhe nuk e ndalojnë këtë gjë. Vallë, heshtja e këtyre dijetarëve apo edhe e gjithë botës, a konsiderohet argument se këto gjëra (taksat e tatimet) janë të lejuara të merren dhe të konfiskohen?! Këtë gjë nuk e pohon as ai që ka fare pak dituri.

Ja një shembull tjetër:

Në Qabe, që, me pajtimin dhe me konsensusin e të gjithë dijetarëve është vendi më i mirë në botë, janë sajuar katër mihrabet¹ nga disa mbretër injorantë e të devijuar,

¹ Janë për qëllim katër mihrabet që gjendeshin në Qabe në kohën e autorit: mihrabi i hanefive, mihrabi i shafive, mihrabi i malikive dhe mihrabi i hanbelive. Çdo mihrab e kishte imamin përkatës që u printe njerëzve për çdo namaz. Rrjedhimisht, hanefiu falej pas imamit hanefi, shafiu pas atij shafi, e kështu me radhë. Kësisoj veprohej gjatë çdo

të cilat i kanë përçarë adhurimet e njerëzve dhe kanë sjellë aq dëme, që vetëm Allahu mund t'i numërojë. Kështu, që përçarë uniteti islam, ndaj dhe qenë bërë sikur të jenë popuj me fe të ndryshme.

Kjo ishte një risi (*bidat*) që e ka kënaqur Iblisin e mallkuar; çka bëri që shejtanët të talleshin me muslimanët, sakaq njerëzit heshtën kundrejt saj: aty vinin dijetarët e të gjitha anëve, zonave e vendeve të ndryshme, ato i pa secili që ka sy, për to dëgjoi çdokush që ka veshë. Vallë, kjo heshtje është argument për lejimin e tyre?! Këtë nuk e thotë as ai, dija e të cilit është fare e cekët.

Të njëjtën gjë e themi edhe për heshtjen kundrejt veprimeve të varradhuresve (*kuburinje*).

namazi. Në të njëjtën kohë faleshin të katër imamët në katër xhemate të ndryshme. Kjo ishte gjë e shëmtuar dhe bidat..." (*Teufiku Rabil ibad, fi sherhi Tat'hiril itikad*, f. 129)

Nëse thua: Kjo detyrimisht tregon se umeti islam ka rënë në ujdi për një gjë që është humbje kur ka heshtur ndaj ndalimit të kësaj të keqeje për shkak të injorancës.

Themi: Realiteti i konsensusit (*ixhmasë*) është pajtimi i dijetarëve muxhtehidë të umetit të Muhamedit, *salallahu alejhi ue selem*, rreth një çështjeje, pas kohës së tij. Dijetarët e katër medhhebeve e konsiderojnë të pamundur të ketë konsensus (*ixhtihad*) pas katër imamëve. Porse, ky mendim është i kotë dhe këtë fjalë mund ta thotë vetëm ai që nuk e di realitetin. Andaj, sipas pretendimit të tyre, nuk ekziston konsensus pas katër imamëve. Domethënë, këtu s'ka vend për këtë pyetje, ngase kjo mveshje dhe fitne e varrezave nuk ka qenë në kohën e katër imamëve të medhhebeve. Në bazë të asaj që thamë, konsensusi nuk mund të ndodhë, sepse umeti i Muhamedit ka mbushur skajet dhe është përhapur në gjithë tokën dhe në tërë këtë nënqiell. Dijetarët e umetit nuk mund të numërohen dhe askush nuk mund ta dijë qëndrimin e secilit. Rrjedhimisht, ai që e pretendon konsensusin pas përhapjes së fesë dhe shtimit tejet të

madh të dijetarëve muslimanë, veçse ka pretenduar rrejshëm, siç e pohojnë këtë imamët e vërtetë.

Po ashtu, supozojmë se këta dijetarë ishin në dijëni për ndodhjen e këtyre gjërave të ndaluara dhe se kanë heshtur ndaj tyre e nuk kanë ndaluar së vepruari, atëherë kjo nuk do të thotë se heshtja e tyre është argument se lejohen, për faktin se është e njohur, në përputhje me rregullat fetare, se ndalimi i të keqes ka tre hapa:

I pari: Ndalimi i të keqes me dorë, duke e ndryshuar dhe duke e hequr atë;

I dyti: Ndalimi i të keqes me gjuhë, në rastet kur nuk mund të ndërhyhet me dorë;

I treti: Ndalimi i të keqes me zemër, në rastet kur nuk ka mundësi të pengohet dhe të heqet as me dorë e as me gjuhë.¹

¹ Bazuar në hadithin e Ebu Said El-Hudriut, *radijallahu anhu*, se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selem*, duke thënë: "*Cilido që sheh ndonjë të keqe, le ta ndryshojë me dorë. Nëse nuk ka*

Nëse ndonjëri prej këtyre hapave pamundësohet, atëherë kalohet te tjetri, si për shembull:

Nëse një dijetar kalon pranë ndonjë doganieri apo taksambledhësi teksa ky i fundit ua merr padrejtësisht taksat apo tatimet njerëzve, ndërkohë që nuk mund ta ndalojë as me dorë e as me gjuhë atë që e merr pasurinë e njerëzve të gjorë, ngase mund të shndërrohet në objekt talljeje nga ata zullumqarë. Meqë në këtë rast i pamundësohet ndalimi i të keqes me dorë apo me gjuhë, mbetet vetëm ndalimi dhe urrejtja me zemër, që njëherit është shkalla më e ulët e besimit.

Pra, po qe se ky dijetar shihet tek hesht kundrejt të këqijave që vepronte ai zullumqar teksa merrte pasurinë e njerëzve, është obligim të mendohet për të se i është pamundësuar ndalimi me dorë e me gjuhë, dhe se ai ka ndaluar dhe ka urreyer me zemrën e tij.

mundësi, me gjuhë. Po qe se nuk mundet, me zemër. Porse, ky është besimi më i dobët." Shënon Muslimi, 49.

Me të vërtetë, të mendosh mirë për muslimanët dhe për njerëzit e fesë është obligim, ndërkaq arsyetimi i tyre, aq sa është e mundur, është gjë e kërkuar.

Pra, ata që hyjnë në Qabenë e ndershme dhe i shohin ato ndërtime djallëzore (katër mihrabet), të cilat e thyen unitetin fetar dhe i ndanë namazet e muslimanëve, arsyetohen për mosndalimin e këtyre gjërave, përveçse me zemër¹ sikurse ata që kalojnë pranë taksambledhësve apo pranë atyre që bëjnë shirk nëpër varreza.

Nga kjo që sapo sqaruam, dihet gabimi i atyre dijetarëve që argumentojnë me konsensus duke thënë se, meqë kjo gjë ka ndodhur e askush nuk ka tërhequr vërejtjen kundrejt saj, konsiderohet konsensus (*ixhma*).

¹ Shejh Abdulaziz Raxhiu thotë: “Ndalimi i të keqes bëhet me dorë, me gjuhë dhe me zemër, andaj dijetari që ka heshtur kundrejt kësaj të keqeje mund të jetë prej atyre që nuk ka pasur mundësi ta ndalojë dhe ta ndryshojë me dorë e as me gjuhë, sepse i është frikësuar dëmit që do të mund t'i bëhej në fenë apo në pasurinë e tij. Ndaj, në këtë rast, të keqen e ka urreyer me zemër dhe është i arsyetuar për mosndalimin me gjuhë.” (*Teufiku Rabil ibad*, f. 127)

Këtu gabimi qëndron në vetë fjalën e tyre “... askush nuk ka tërhequr vërejtjen...”, sepse është pretendim i njohjes së të fshehtës, ngase, ka mundësi ta kenë ndaluar dhe ta kenë urryer shumë zemra, që kanë qenë të paafta për t'i ndaluar me dorë apo me gjuhë.

Ti je dëshmitar se në kohën tonë ndodhin shumë gjëra të këqija, që nuk mund t'i ndalosh as me gjuhë e as me dorën tënde, porse i urren me zemër. Ndërkaq, ai që nuk e di, tek të sheh duke heshtur, thotë se filani ka heshtur kundrejt haramit. E, këtë e thotë ose në formë qortimi, ose duke të të pasur model për të heshtur edhe vetë. Andaj, heshtja kurrsesi nuk mund të merret për argument.

Po ashtu, është i kotë argumentimi i tyre: “Filani ka vepruar diçka, kurse të tjerët kanë heshtur, rrjedhimisht një gjë e tillë konsiderohet *ixhma*.”¹ Kjo është gabim për dy arsye:

¹ Dijetarët këtë e quajnë *ixhma sukuti*, d.m.th. “konsensus i heshtur”, gjë për të cilën dijetarët kanë mospajtime. Kështu, shumica e dijetarëve

E para: Pretendimi se heshtja e të tjerëve është pranim i veprës së filanit, e tani më e kuptove se heshtja nuk konsiderohet pranim.

E dyta: Fjala e tyre “... konsiderohet konsensus (*ixhma*)”, ndërkaq, është e njohur se konsensus është rënia në ujdi e muxtëhidëve të umetit të Muhamedit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ngase i heshturi nuk domethënë se i referohet pajtimit apo kundërshtimit të një çështjeje, derisa kjo të njihet nga vetë fjala e tij.

Një mbret, teksa njerëzit që ishin të pranishëm e lavdëruan njërin nga punëtorët e tij, njërit prej tyre, që kishte heshtur, i kishte thënë: “Ç’është puna jote? Nuk po thua atë që thonë ata?” I heshturi ia ktheu “Po qe se do të flisja, do t’i kundërshtoja.”

Andaj, jo çdo heshtje konsiderohet pëlqim, sidomos kur dihet se këto haramë dhe këto të këqija i ka përcaktuar ai,

e pranojnë dhe thonë se kjo ka mundësi të ndodhë. Por, një pjesë e tyre, të cilëve u përket edhe autori, e refuzojnë një gjë të tillë. (Po aty, f. 138)

në dorën e të cilit është shpata, fuqia dhe forca, ku gjaku dhe pasuria e njerëzve janë nën pushtetin e tij. Atëherë, si ka mundësi që një person i vetëm t'i kundërshtojë gjithë këto gjëra?

Të gjitha këto kupola, tempuj e tyrbe janë bërë mjetet kryesore që shpiejnë në shirk dhe në mosbesim, mjete kryesore që çojnë drejt shkatërrimit të Islamit dhe drejt thyerjes së fortifikatës së tij. Kryesisht ata që i ndërtojnë dhe kujdesen për to janë mbretërit, pushtetarët, kryetarët dhe prijësit; ua ngrehin ndonjë të afërmi të tyre, ose ndonjërit që kanë mendim të mirë për të, si: dijetar evlija, asket, të varfër, plak të moçëm. Fillimisht atë (ngrehinë) njerëzit e vizitojnë si vizitë të rëndomtë të një të vdekuri, pa i kërkuar ndërmjetësim, pa ia thirrur emrin, thjesht luten për të dhe kërkojnë që Allahu ta falë. Kësisoj, vazhdohet derisa të kalojë brezi që e njihte, e pas tyre vijnë breza që e shohin varrin se si i është ndërtuar: qirinj të ndezur, shtroja të shtrenjta rreth tij, perde të varura përreth, lule të vëna mbi të, rrjedhimisht fillojnë të besojnë se kjo është për t'u sjellë dobi dhe për t'ua larguar dëmin. Më pas, aty shfaqen ciceronët a

mbikqyrësit e varrit apo tyrbes dhe gënjejnë për të vdekurin se paskësh bërë kështu e ashtu, i paskësh sjellë dobi atij e i paskësh bërë dëm këtij... vazhdohet në këtë mënyrë derisa të mbillet çdo kotësi.¹

Për këtë çështje, në thënie profetike, është cekur mallkimi i Allahut për atë që ndez qirinj mbi varre, shkruan dhe ndërton mbi to. Hadithet me këtë tematikë janë të shumta dhe të njohura,² andaj një gjë e tillë është

¹ Këta janë hapat e shejtanit, hapa të cilët i ndoqi edhe më parë kur ndryshoi simbolet e fesë dhe kur e shpiku shirkun në të cilin kishte rënë populli i Nuhut, *alejhi selam*. Ibn Abasi, *radijallahu anhuma*, pohon: "Idhujt e adhuruar nga populli i Nuhut mbanin emra të disa njerëzve të mirë. Kur vdiqën, shejtani e cyti popullin e tyre duke i thënë: 'Në vendet ku uleshin ngrini nga një shtyllë me dukjen dhe me emrat e tyre.' Gjë të cilën e bënë, porse fillimisht nuk i adhuruan. Me të kaluar ky brez dhe me të humbur dija, erdhi brezi që i adhuroi." Shënon Buhariu, 4920.

² Ibn Abasi, *radijallahu anhu*, përcjell se i Dërguari i Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: "Allahu i ka mallkuar gratë që i vizitojnë varrezat dhe ata që varret i shndërrojnë në xhami duke i ndriçuar ato." Shënojnë Ebu Davudi, 3236; Tirmidhiu, 320; Nesaiu, 2042; dhe Hakimi, 1/374.

Aishja, *radijallahu anha*, tregon se i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, gjatë sëmundjes, prej të cilës vdiq, thoshte: "Allahu i mallkoftë hebrejntë

prej gjërave të ndaluara dhe mjet që shpie te një e keqe e madhe.

Nëse thua: Ja, tek është varri i të Dërguarit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ndërtuar mbi të ajo kupolë e madhe, në të cilën janë shpenzuar para të shumta?

Themi: Këtu ka injorancë në njohjen e thelbit të çështjes, ngase atë nuk e ka ndërtuar i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, as shokët e tij, as tabiinët, as ata që erdhën pas këtyre e as dijetarët dhe imamët e umetit, *Allahu i mëshiroftë!* Mirëpo, kupola e ndërtuar mbi varrin e zotërisë së të dërguarve, *alejhi salatu ue selam*, është nga ndërtimet e njërit prej mbretëve të vonshëm të Egjiptit, i

dhe të krishterët: varret e të dërguarve të tyre i shndërruan në xhami." Aishja, *radijallahu anha*, më tej thotë: "Po të mos ishte ky shkak, varri i tij do të lihej në dukje, i parrethuar. Mirëpo, kam frikë se i shndërrohet në xhami (d. m. th. njerëzit falen dhe luten aty)." Shënojnë Buhariu, 1330; dhe Muslimi, 529.

Gjithashtu, Xhabiri, *radijallahu anhu*, thotë: "I Dërguari i Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selem*, e ka ndaluar shkrimin, uljen dhe ndërtimin mbi varre." Shënon Muslimi, 970.

quajtur Kalavun Es-Salihiu, i njohur si Mbreti Mensur, në vitin 678 h. Kjo çështje përmendet në librin *Tahkiku nusrah bi telkhisi talimi daril hixhrah*. Ndaj, këto janë çështje shtetërore, jo argumente që duhet pasuar.¹

Kjo është çështja e fundit që deshëm ta sqaronim, ngase është përhapur çdokund, atë e ndoqën epshet dhe e anashkaluan dijetarët, duke mos ndaluar kundrejt saj, gjë për të cilën janë të obliguar, porse anuan kah anuan njerëzit e rëndomtë. E, si pasojë e kësaj, e keqja u bë e mirë, kurse e mira e keqe. Rrjedhimisht nuk gjen askë që ndalon nga kjo e që tërheq vërejtjen.

Nëse thua: Një grup njerëzish, që bëjnë vepra përtej përceptimit njerëzor, të quajtur *mexhadhibë*,² ndonjëherë

¹ S'ka dyshim se kupola mbi varrin e të Dërguarit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, nuk i përket aspak Islamit, madje prania e saj është nga sprovat më të mëdha me të cilën shejtani ua zbukuron punën miqve të tij varradhures (*kuburinj*), të cilët e konsiderojnë argumentin më të madh për ta arsyetuar të kotën në të cilën gjenden.

² *Mexhadhibë* quhen persona të veçantë në mesin e sufive, të cilët pretendojnë se kanë arritur gradë të lartë duke bërë ziqër (dhikër) të ndryshëm, saqë pasuesit e tyre besojnë se këta e udhëheqin gjithësinë

ka mundësi të kenë lidhje me të gjallët apo me të vdekurit. Cili është gjykimi për ta dhe për veprat e tyre, kur dihet se gjërat e tilla i pranon dhe i beson natyrshmëria e zemrave?

Them: Të ashtuquajturit *mexhadhibë*, të cilët e përsërisin vazhdimisht fjalën *Allah*¹ me gojët dhe me gjuhët e tyre duke e ndryshuar nga tingujt që ka gjuha arabe, janë

dhe kanë mundësi të ndikojnë në gjëra që janë vetëm në kompetencën e Allahut të Lartësuar.

Përgjithësisht sufitetë ndahen në tri shtresa: 1. Shtresa e rëndomtë; 2. Shtresa e veçantë; 3. Shtresa më se e veçantë. Secila shtresë ka ziqër të veçantë. Kështu, ziqri i të rëndomtëve, që, sipas tyre, hyjnë edhe të dërguarit(!), është: *subhanallah, elhamdulillah, La ilahe il-IAllah, Allahu ekber*. Ziqri i të veçantëve është: *Allah, Allah*, që e thonë deri sa t'u bjerë të fikët e të bien për tokë. Ndërkaq, ziqri i më se të veçantëve është tingulli *h* i emrit *Allah*, që thonë: *hu, hu*, ku për qëllim e kanë Allahun..." (*Teufiku Rabil ibad*, f. 145)

¹ Ky është ziqri që bëjnë sufitetë: mblidhen në tyrbet e tyre apo në ndonjë vend tjetër të ngjashëm dhe fillojnë ta përmendin emrin *Allah* bashkërisht dhe ta përsërisin mijëra herë. Kësaj ia bashkangjesin edhe kërcimin që bëjnë poshtë e lart... S'ka dyshim se një gjë e këtillë nuk ka të bëjë asgjë me Islamin e vërtetë dhe se është në kundërshtim të plotë me Kuranin dhe me Sunetin e të Dërguarit, *sal-lallahu alejhi ue selem*.

ushtarë të Iblisit të mallkuar dhe ndër gomarët më të mëdhenj të rruzullit tokësor. Atyre shejtanët ua kanë veshur rrobat e zbukurimit dhe mashtrimit, ngase shqiptimi veçmas i fjalës *Allah*, pa përmendur ndonjë cilësi të Tij, (si: Allah! Allah!), nuk konsiderohet fjalë apo teuhid më vete, porse kjo është përqeshje me këtë fjalë të shenjtë, ngase fillimisht po shtrembërohet, pastaj po i zhveshet kuptimi që ka. Po që se do të ishte një njeri i rëndësishëm e me pozitë, fjala vjen, i quajtur Zejd, e të ngrihej një grup njerëzish duke e thirrur atë: Zejd! Zejd!, do të konsiderohej tallje, nënçmim dhe përqeshje ndaj tij, shtoja kësaj edhe shtrembërimin e emrit të tij.

Pastaj, shiko në Kuran dhe në Sunet se a është përmendur ndokund fjala *Allah* veçmas apo e përsëritur? Ajo që ka ardhur në Kuran dhe në Sunet është përmendja e Allahut me njësim, me lavdërim dhe me madhërim.¹ Ja, këto janë dhikri dhe duatë e të Dërguarit, *sal-lallahu*

¹ Janë për qëllim fjalët: *subhanallah, elhamdulillah, La ilahe il-Allah* etj., të cilat përmenden nëpër duatë e Sunetit.

alejhi ue selem, familjes dhe shokëve të tij; nuk përmbajnë këso lloj zërash, britma e llomotitje, me të cilat është adaptuar ai që është larg Allahut të Lartësuar dhe larg udhëzimit e sjelljes së të Dërguarit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, i lënë në ndonjë vend të braktisur.

Të këtillët ndonjëherë fjalës *Allah* i shtojnë emra të njerëzve të vdekur, si: Ibn Ulvan, Ahmed ibn Husejn, Abdul Kadir, Ajderus etj. Madje, çështja ka shkuar deri aty saqë në ato varre e tyrbe janë të varrosur zullumqarë e mëkatarë të prishur. Mirëpo, për fat të mirë, Allahu i Lartësuar e ka ruajtur të Dërguarin, *sal-lallahu alejhi ue selem*, dhe shokët e tij nga gjuhët e këtyre injorantëve të humbur, të cilët i kanë përzier të gjitha llojet e injorancës, shirkut dhe kufrit.

Nëse thua: Këtyre, që e bëjnë këtë lloj ziqri, duke ia shtuar emrit *Allah* emra të tjerë, të njerëzve të prishur dhe amoralë, mund t'u ndodhin gjëra të jashtëzakonshme (keramete), si: shpuarja që i bëjnë vetes, bartja e gjarpërinjve, e akrepave etj., futja e zjarrit në gojë, prekja

e tij (zarrit) me dorë dhe me trup, ndërkohë që s'u ngjet kurrfarë dëmi.

Them: Këto gjëra janë prej shejtanit. Vërtet mashtrohesh tek mendon se ato janë mrekulli të të vdekurve apo vepra të mira të të gjallëve, ngase kur ky i devijuar i thërret ata të vdekur me emrat e tyre, e bashkëshoqëron Allahun në krijim dhe në kader (përcaktim), ndërkaq për ata të vdekur apo të varrosur në atë vend pretendon se janë njerëz të dashur të Allahut të Lartësuar.

Atëherë, mendon se ky i dashur i Allahut është i kënaqur ta bësh bashkëshoqërues të Allahut?

Po qe se ke këtë mendim, dije se ke sjellë një ves të shëmtuar dhe se ata të vdekur i ke shpallur mushrikë, i ke nxjerrë prej Islamit, duke ia shoqëruar ata Allahut, kinse pajtohen e janë të kënaqur me këtë. Po ashtu, veprat që i përmende pretendon se janë mrekulli të sufive të humbur e mushrikë, të cilët pasojnë çdo të kotë, që janë të përmbytur në detin e ndyrësirave e që nuk i bëjnë sexhde Allahut e as që e përmendin Atë, të Vetmin.

Nëse pretendon një gjë të këtillë, atëherë ti pranon se idhujtarëve, jobesimtarëve dhe të çmendurve u ngjajnë gjëra të jashtëzakonshme (keramete), me ç'rast i ke thyer rregullat e Islamit, parimet e fesë së qartë dhe të sheriatit të drejtë.¹

Shejtani kujdesin më të madh e ka në devijimin e njerëzve nga rruga e drejtë dhe e udhëzimit. Ebu Bekër El-Bezari përcjell në *Musnedin* e tij nga Muavije ibn Kurrah, e ky nga babai i tij, tek thotë:

“Së bashku me babanë tim donim ta takonim të Dërguarin, *sal-lallahu alejhi ue selem*. Në rrugë e sipër kaluam nëpër një lagje, ku dhe bujtëm. Ndërkohë, një bari erdhi te banorët e lagjes. Teksa vraponte, u tha: ‘Nuk jam ruajtës i duhur: çdo natë vjen ujku dhe merr nga një dele prej kopesë, kurse idhulli e sheh, por nuk e ndal e as nuk pengon atë!’

¹ Fetarisht mrekullitë mund t’u ndodhin vetëm të dërguarve dhe njerëzve të mirë e të devotshëm, kurrsesi politeistëve (mushrikëve), jobesimtarëve (qafirëve) e mëkatarëve të mëdhenj.

I thanë: 'Qëndro aty derisa t'i vemi atij!'

Kështu, vajtën tek idhulli dhe i folën rreth kësaj çështjeje.
Pastaj bariu u tha: 'Rrini natën.'

I thanë: 'Do të qëndrojmë derisa të shohim.'

Vazhdon: Po atë natë bujtëm derisa erdhi koha e namazit të sabahut. Bariu rierdhi me nxitim te banorët e fshatit duke u thënë: 'Përgëzohuni! A nuk e keni parë ujkun ulur mes kopesë, duke mos qenë i lidhur me kurrfarë litari!'

Rrëfen: Vajtëm me ta për të shikuar dhe tha: 'Po, kështu duhet të veprosh.'

Pas kësaj arritëm tek i Dërguari i Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selem*. Im atë i tregoi atë që kishim parë, ndërkaq i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, tha: "*Shejtani luan me ta.*"

Meqë shejtani paskësh mundësi të shndërrohet në ujk e të ulet në mes delesh vetëm për t'i devijuar njerëzit e t'i bëjë t'i adhurojnë idhujt, atëherë përse besimtari, që ka

iman të sinqertë, çuditet nga loja që shejtani ua bën *mexhadhibëve*¹ dhe *kuburive* (varradhuresve), duke iu personifikuar në formë gjarpri, të cilin e pështjellin në duart e tyre, apo në zjarr, të cilin e hanë, apo në diç tjetër. Ndaj, me këtë nuk është për t'u habitur ai që ka iman dhe bindje të vërtetë.

Ibn Tejmije në librin e tij *Dallimi mes miqve të të Gjithëmëshirshmit dhe atyre të shejtanit* tregon se personalisht njihte një njeri të cilit i flisnin bimët, duke e njoftuar për dobitë e veta që përmbajnë. Në të vërtetë atij i flitnin shejtanët futur brenda atyre bimëve.

Vazhdon më tutje (Ibn Tejmije): Njoh dikë të cilit i flasin guri e bima, duke i thënë: “Lum për ty, o mik i

¹ Këtu me *mexhadhibë* janë për qëllim magjistarët që aktojnë në cirqe apo në vende të ngjashme, tek luajnë me gjarpërinj, duke i sjellë përreth trupit, apo që luajnë me zjarr, duke e prekur e duke e futur në gojë, ndërkohë që s'u ndodh asgjë e keqe. Siç shpjegon edhe autori, një gjë të tillë e bëjnë me ndihmën e shejtanëve.

Allahut!” Ndërkaq, ky ua lexon *Ajetul kursinë*,¹ e kështu i largohen.

Po ashtu tregon: Njoh dikë që shkon në gjueti të shpendëve, të cilit i flasin zogjtë, duke i thënë: “Më gjuaj, që të më hanë të varfrit.” Shejtanët u futen atyre, siç u futen njerëzve, dhe u flasin. Ka të atillë që, nga brendia e shtëpisë e sheh veten se është jashtë saj, dhe anasjelltas, ndërkohë ai as që e ka hapur atë. Gjithashtu, ndodh që në dyert e Medinës ta marrin xhinët duke e futur e duke e nxjerrë me shpejtësi prej saj, ndërkohë që shihet në formë dritash dhe është i pranishëm aty ku e kërkojnë.

Kjo bëhet përmes shejtanëve, të cilët personifikohen në fizionominë e atij njeriu.

Gjithashtu thotë: Njoh dikë të cilit i flet dikush duke i thënë: “Unë vij me urdhrin e Allahut”, e i thotë se, “ti je Mehdiu, për të cilin ka lajmëruar i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem.*” Kështu, atij i paraqiten gjëra të

¹¹ Ajeti 255 i sures Bekare.

jashtëzakonshme, si: të mendojë me zemrën e tij se në ajër po shndërrohet në zog, në insekt apo në kafshë. Çkado që të mendojë, ashtu ndodh, pa bërë asnjë ndërhyrje të jashtme.

Po ashtu, bartet deri në Mekë (nga shejtanët) dhe kthehet. Më pas i vijnë persona me pamje të bukur dhe i thonë se, këta qenë melekët, që erdhën të të vizitojnë. Pastaj mendon në vete: Si janë paraqitur në fizionominë e djelmoshave të bukur?! E ngreh kokën lart, dhe ja, ata zhduken!

Të gjitha këto gjëra janë mashtrime të shejtanit. Po të përmendja gjithë çka di rreth kësaj çështjeje, do të nevojitej një vëllim tejet i madh për t'i përfshirë. Allahu i Lartësuar thotë:

﴿ فَأَمَّا الْإِنْسَانُ إِذَا مَا ابْتَلَاهُ رَبُّهُ فَأَكْرَمَهُ وَنَعَّمَهُ فَيَقُولُ رَبِّي أَكْرَمَنِ ﴿١٥﴾ وَأَمَّا إِذَا مَا ابْتَلَاهُ فَقَدَرَ

عَلَيْهِ رِزْقَهُ فَيَقُولُ رَبِّيَ أَهْنَنَ ﴿١٦﴾ كَلَّا ﴿١٧﴾ [الفجر: ١٥ - ١٧]

“E njeriu, kur e sprovon Zoti i tij, e nderon dhe e begaton, thotë: “Zoti im më ka nderuar!” Por, kur për ta sprovuar ia pakëson furnizimin (e varfëron), ai thotë: “Zoti im më ka nënçmuar!” Jo, nuk është

ashtu..." (Fexhr, 15-17)

Qorton dhe tërheq vërejtjen se jo çdokujt që ka arritur ndonjë të mirë të kësaj bote i llogaritet mrekulli e as nderim i Allahut ndaj tij. Gjithashtu, jo çdo i privuar apo çdokush të cilit i është ngushtuar rrisku konsiderohet i nënçmuar e i ulët, ngase Allahu i Lartësuar e sprovon robin e Tij me lehtësime e me vështirësi: ndodh t'i japë të mira atij që nuk e do dhe as që është i ndershëm tek Ai, porse e sprovon dalëngadalë. Në anën tjetër, ndodh që ia privon të mirat atij që e do dhe e ka mik, që të mos iulet pozita që ka tek Ai dhe, shkak i tyre, të mos i ndodhë ndonjë e keqe, të cilën nuk ia do Allahu.

Ndaj, *kerametet*, mrekullitë e miqve të Allahut, medoemos duhet të jenë rezultat i *besimit* dhe *devotshmërisë*. Sa herë që *kufri*, *mëkati* dhe *mosbindja* janë rezultat i tyre, ato janë veprime të armiqve të Allahut, kurrsesi mrekulli të miqve të Tij.

Rrjedhimisht, ato që cekëm më lart janë prej shejtanëve, që përfshihen në fjalën e Allahut të Lartësuar:

﴿ وَمَنْ يَعِشْ عَنِ ذِكْرِ الرَّحْمَنِ نُقِضْ لَهُ شَيْطَانًا فَهُوَ لَهُ قَرِينٌ ﴿٣٧﴾ وَإِنَّهُمْ لَيَصُدُّونَهُمْ عَنِ

السَّبِيلِ وَيَحْسَبُونَ أَنَّهُمْ مُّهْتَدُونَ ﴿٣٧﴾ حَتَّىٰ إِذَا جَاءَنَا قَالَ يَا لَيْتَ بَيْنِي وَبَيْنَكَ بُعْدَ الْمَشْرِقَيْنِ

فَيَسَّ الْقَرْيَةَ ﴿٣٨﴾ وَلَنْ يَنْفَعَكُمْ الْيَوْمَ إِذْ ظَلَمْتُمْ أَنْفُسَكُمْ فِي الْعَذَابِ مُشْتَرِكُونَ ﴿٣٩﴾

[الزخرف: ٣٦ – ٣٩]

“Atij që mbyll sytë para këshillave të Zotit, ia shoqërojmë një djall që nuk i ndahet kurrë. E ata do t'i shmangin nga rruga e drejtë, kurse (jobesimtarët) mendojnë se janë duke i udhëzuar. E kur të vijë ai (jobesimtari) para Nesh, do të thotë: “Ah, të kishim qenë larg mes vete sa Lindja me Perëndimin; sa shok i keq je ti!”. Dhe sot, për shkak se ishit zullumqarë, shoqërimi juaj nuk do t'ju bëjë dobi në vuajtjet tuaja.” (Zuhruf, 36-39)

Nëse e kuptove se këto gjëra janë të kota, atëherë dije se ato që u përmendën janë prej shejtanit, janë vepra të *tagutit*, punë të Iblisit, të cilat shejtanët ua ofrojnë në shërbim sivëllezërve të tyre të humbur, atyre që u cekën, duke u ndihmuar të dy palët mes vete, për t'i devijuar njerëzit.

E vërteta rreth magjisë dhe magjistarëve

Është konfirmuar në hadithe se shejtanët dhe xhinët mund të marrin formën e gjarprit apo bollës.¹ Kjo është çështje e prerë që mund të ndodhë. Pra, gjarpërinjtë që i sheh njeriu në duart e atyre njerëzve, mund të jenë nga magjia, e cila është shumë llojesh, mësimi i së cilës nuk është aq i vështirë, porse çelësi i saj është kufri - mohimi i Allahut dhe poshtërimi i asaj që ka madhëruar Allahu, siç është hedhja e Kuranit në vende të ndyta dhe gjëra të ngjashme.

Ndaj, ai që i sheh këto gjëra të *mexhadhibëve*, e që nga këndvështrimi i tij mund të duken si mrekulli, mos të mashtrohet, ngase magjia ka ndikim të madh në veprime. E, kjo vlen edhe ndaj atyre që disa gjëra i shndërrojnë në

¹ Shejtani mund të shndërrohet në formë të gjarprit, të akrepit, të maces, të qenit etj. Kjo është çështje që ngjet me të vërtetë. Mirëpo gjarpërinjtë, a çkado tjetër, që shihet në duart e magjistarit, thjesht janë xhinë apo shejtanë dhe, me të përmendur emrin e Allahut, ikin.

gjësende të tjera. Tërë këtë e bëjnë përmes magjisë (sihrit).¹

Në këtë mënyrë, edhe magjistarët e Faraonit e mbuluan luginën me bolla e me gjarpërinj, saqë Musai, *alejhi selam*, u frikësua nga kjo, kurse Allahu i Lartësuar këtë ndodhi e cilësoi si një *magji të madhe*. Andaj, magjia bën gjëra edhe më të mëdha se kjo.

Ibn Batuta dhe të tjerë kanë përmendur se në Indi kanë parë njerëz të cilëve u ndizet një zjarr i madh. Pastaj, veshin rroba fare të holla dhe futen në të (në zjarr), e dalin prej tij, kurse rrobat e tyre sikur të mos i prekte asgjë.

Gjithashtu, përmend se te disa mbretër të Indisë kishte parë një person se si kishte ardhur me dy djelmosha dhe i kishte prerë copë-copë. Më pas, copat e tyre i paskësh

¹ Magjistarët nuk kanë mundësi t'i shndërrojnë gjësendet në diçka tjetër, fjala vjen, ta shndërrojë gomarin në njeri, apo njeriun në gomar; drurin në flori dhe anasjelltas. Mirëpo, kjo duket vetëm në sytë e njerëzve për shkak të magjisë që bëjnë përmes shejtanëve.

plasur një nga një në drejtime të ndryshme, saqë askush nuk mund t'i shihte më. Pastaj, paskësh bërtitur e paskësh qarë, ndërkaq, pa u vërejtur aspak nga të pranishmit, copat e secilit djalë paskëshin ardhur veçmas dhe qenkëshin bashkuar me njëra-tjetrën, derisa u ngritën që të dytë, siç kanë qenë më parë: të gjallë dhe të plotë.

Këtë e rrëfen Ibn Batutah në *Udhëtimet e tij*, kurse udhëtimi në fjalë është version i shkurtuar, që e kam lexuar në Mekë, më 1136 h, e që na e ka treguar dijetari dhe myftiu hanefit në Medinë, Sejid Muhamed ibn Esadi, *Allahu e mëshiroftë!*

Në librin *El-Egani*, Ebul Ferexh El-Asfahani, me varg të saktë transmetimi, përmend se si një magjistar kishte shkuar te Velid ibn Ukbe (prijës i Irakut në atë kohë). Magjistari, me magjinë e tij, zuri të futej në brendinë e lopës dhe të dalë që andej. Këtë veprim e kishte parë Xhundubi, *radijallahu anhu*, i cili vajti në shtëpi, e mori shpatën dhe, në momentin kur magjistari hyri brenda lopës, ky e recitoi ajetin kuranor:

﴿أَفَأَتُوكَ السِّحْرَ وَأنتَ بُصْرُوكَ﴾ [الأنبياء: 3]

“A do t’ia pranoni magjinë e tij kur ju po e dini?”
(Enbija, 3)

Pastaj, me shpatën e tij, e goditi lopën në mes dhe e ndau në dysh, lopën bashkë me magjistarin.

Njerëzit u trazuan. Ndërkaq, Velidi e burgosi Xhundubin dhe i shkroi Othmanit, *radijallahu anhu*, rreth asaj që kishte ngjarë.

Në burg qëlloi një i burgosur i krishterë. Kur ky i fundit e pa Xhundubin se si falej natën e agjëronte ditën, tha: “Për Allahun, meqë më i keqi i këtyre njerëzve (muslimanëve) qenka i këtillë, me siguri duhet të jenë njerëz të vërtetë.” Pastaj, në burg la një njeri në vend të vetin. Doli në Kufe. E kërkonte njeriun më të mirë në atë vend. I thanë se ai (njeriu më i mirë) është Eshath ibn Kajsi. I krishteri vajti tek ai dhe i kërkoi ta pranonte si mysafir. Pa se Eshathi flinte natën. Gjithashtu, kur zbardhi dita, ushqej. Iku prej tij për të pyetur se cili është njeriu më i mirë në Kufe. I thanë se ai është Xheriri. Shkoi edhe tek ai. Edhe këtë e

pa tek flinte natën e hante gjatë ditës. Me të parë tërë këtë, u kthye kah kibleja dhe thirri: "Zoti im është Zoti i Xhundubit. Feja ime është feja e Xhundubit." E kështu u bë musliman.

Këtë tregim e përcjell edhe Bejhakiu në *Sunenul kubra*, me ca ndryshime.

Po ashtu, me zinxhir të saktë transmetimi përcjell nga Ebul Esvedi se Velid ibn Ukbe ishte në Irak. Para këtij luante një magjistar. Ai ia prente kokën një neri. Më pas ngrihej dhe e thërriste duke bërtitur. Kështu, koka i kthehej siç ishte.¹ Të pranishmit thanë: "Subhanallah! I ngjallka të vdekurit!" Tërë këtë skenë po e përcillte njëri

¹ Ç'është e vërteta, në këtë shembull dhe në atë të përmendur më parë, magjistari nuk ka mundësi të futet brenda lopës e as ta ringjallë të vdekurin. Mirëpo, ai u bën magji syve të njerëzve, ndaj u duket se me të vërtetë hyn brenda, ia pren kokën njeriut dhe e ngjall atë. Thjesht, kjo është magji. Ndërkaq, e vërteta është se ai ecën nën lopë, duke u futur nën të dhe mes këmbëve të saj. Gjithashtu, në rastin e dytë, sikur t'ia heqte kokën përnjëmend, ai nuk do të ringjallej më kurrë. Këtë që po themi e vërteton fakti se magjistari s'e ngjalli dot veten pasi ia preu kokën Xhundubi, *radijallahu anhu!* Andaj, medito në këtë, Allahu të mëshiroftë!

nga muhaxhirët (shok i të Dërguarit, *sal-lallahu alejhi ue selem*). E, kur zbardhi e nesërmja, ky (muhaxhiri) e mori shpatën me vete. Teksa magjistari e bënte lojën e tij, sahabiu, *radijallahu anhu*, e nxori shpatën dhe ia preu kokën vetë magjistarit. Pastaj tha: "Meqë qenkësh i vërtetë, le ta ringjallë vetveten."

Velidi e urdhëroi rojën e burgut ta kapte, për ta burgosur.

Më e çuditshme se kjo është ajo çfarë përcjell hafidh Ebu Bekër El-Bejhakiu, me zinxhir të saktë transmetimi, në një tregim të gjatë, ku, ndër të tjera, thotë se një grua e kishte mësuar magjinë prej dy engjëjve të Babilonisë, prej Harutit dhe Marutit.

Kështu, kishte marrë ca grurë dhe e kishte hedhur në tokë. Më pas i kishte thënë të mbijë dhe gruri kishte mbirë mbi tokë. Pas kësaj i kishte thënë të formohej, ndaj dhe gruri qe bërë kalli. Pasi që e kishte fërkuar dhe e kishte qëruar i kishte thënë të piqej, ndaj dhe gruri ishte pjekur. Pastaj i kishte thënë të bluhej, ndaj dhe ishte bluar. Më tutje i kishte thënë të bëhej bukë, ndaj dhe ishte

bërë bukë. Kur dëshironte diçka kjo grua, s'kishte gjë që s'bëhej.¹

Rastet dhe ngjarjet me shejtanët nuk kanë kufij. Mjafton të përmendet atë që na e ka treguar i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, rreth Dexhalit.²

Mirëpo, në raste të këtilla kriteri dallues qëndron në pasimin e Kuranit e të Sunetit dhe në kundërshtimin e tyre.¹

¹ Shih: *Es-Sunenul kubra*, të Bejhakiut, 1/137.

² Dexhali do të dalë në kohën e fundit, para Kiametit, siç tregohet në hadithe të sakta; vjen me gjëra të jashtëzakonshme. Allahu ia mundëson t'i sprovëjë njerëzit. Prej gjërave që bën ai, janë: e urdhëron qiellin të lëshojë shi, bie shi; e urdhëron tokën të mbijë bimë, mbijnë; njeriun e ndan në dysh me shpatën e tij, pastaj e urdhëron të ringjallet, ringjallet, si dhe vepra të tjera të përmendura në hadithe. Dexhali është i verbër në njërin sy, në ballë ka të shkruar *qafir*, që mund ta lexojë çdo besimtar. Ai është sprova më e madhe e të gjitha kohëve. I Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, na ka mësuar që në çdo namaz t'i lutemi Allahut të na mbrojë prej sprovës së Dexhalit. E lusim Allahun e Lartësuar të na mbrojë prej sprovës së tij! Amin!

Këtu mbaron ajo që donim të thoshim.

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve, në fillim e në mbarim, haptas e fshehtas, ndërkaq paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi Muhamedin, mbi familjen dhe mbi shokët e tij.

Çdo ndryshim gjendjeje e çdo fuqi vjen vetëm prej Allahut, më të Lartit, më të Madhit.

¹ Çdo gjë që është në përputhje me Kuranin dhe me Sunetin, pranohet dhe punohet sipas saj, kurse ajo që është në kundërshtim me to, refuzohet.

Përmbajtja

Tema	Faqe
Njohje me autorin	3
Hyrja	9
Kapitulli: Disa baza të fesë	13
Baza e parë: Ç'ka në Kuran është e vërtetë (hak).	13
Baza e dytë: Të dërguarit e Allahut janë dërguar për ta njësuar Allahun në adhurim.	14
Baza e tretë: Llojet e teuhidit	15
Lloji i parë	15
Lloji i dytë	16
Baza e katërt: Idhujtarët (mushrikët) besonin se Allahu i Lartësuar është Krijues i tyre.	22
Baza e pestë: Thelbi i adhurimit është njësimi i Allahut	27
Kapitulli: Llojet e adhurimit	30
Të dërguarit janë dërguar për ta njësuar Allahun në adhurim	32
Kapitulli: Nuk mjafton vetëm besimi në Zotin, po qe se	41

Kapitulli: Bindja në dikë tjetër pos Allahut është shirk	47
Dialog me varradhuresin	56
Nuk i vlen shehadeti, as namazi etj. atij që bën shirk	74
Prerja e kurbanit dhe zotimi (<i>nedhri</i>) lejohen vetëm për Allahun	83
Përhapja e ndonjë të keqeje nuk është tregues saktësie	91
E vërteta rreth magjisë dhe magjistarëve	118
Përmbajtja	126